



Objektiv

Viti I i botimit

Nr. 2

Maj-Korrik

Çmimi 250 Lekë - 2 Euro

Editorial

Si ta lexojmë
23 qershorin?

Politikë

Zgjedhjet, Shqipëria
kaloi klasën?

Sociale

Tiranë, një në pesë
dyqane vidhen

Opinion

Dyzimi i simbolikës
kombëtare

Objektiv

Kryeredaktor
Ramadan Çipuri

Redaksia
Alba Boriçi
Emirjon Senja
Erlis Çela
Ilda Shytaj
Luis Bekteshi
Rudi Dunga

Grupi i këshilltarëve
Agron Hoxha
Agron Tufa
Alban Tartari
Briseida Mema
Gentiana Skura
Idaver Sherifi

Këshilli i etikës
Aleksandër Çipa
Bashkim Gjergji
Lutfi Dervishi
Mark Marku

Kontribuan në këtë numër
Altin Tufa
Erilda Sulika
Jola Lozhi
Muzafer Dema

Redaktor letrar
Rrahim Ombashi

Marketingu
Rudi Dunga
Blerand Ismaili
Erzen Carja

Dizajn
Ejup Lila

Fotografia
Ejup Lila
Irfan Karaabo

Telefon
+355 42 419 222
+355 67 30 44 464

Adresa: Rr. Jordan Misja, Kompleksi Usluga,
Tiranë - Shqipëri

Editorial

Si ta lexojmë 23 qershorin? - Ramadan Çipuri

Opinion

Dyzimi i simbolikës kombëtare - Mark Marku

Aktualitet

Zgjedhjet e 23 qershorit - Emirjon Senja

Opinion

Revolucion social apo manipulim social - Alban Tartari

Shkence

Studimi i geneve, shqiptarët ngjajnë më shumë me evropianët
Jola Llozhi

Opinion

Po media i arriti standardet?! - Erlis Çela

Panshqiptare

Rotacioni politik në Shqipëri dhe ridimensionimi i
marrëdhënieve me Kosovën - Rudi Dunga

Sociale

Mania Facebook - Luis Bekteshi

Reportazh

Korça me Vila Zotërinjsh - Rahim Ombashi

Reportazh

Atje ku gurët fluturojnë - Jola Llozhi dhe Altin Tufa

Reportazh

Të jetosh me frikën e vdekjes - Erilda Sulika dhe
Muzafer Dema

Sociale

Tiranë, një në pesë dyqane vidhen – Ilda Shytaj dhe Luis
Bekteshi

Gjuhë dhe kulturë

Mbi disa aspekte të komunikimit virtual – Jolanda Lila

Shendetesi

Migrena – Oltjon Albajrami

Dossier

Lasgush Poradeci, raportet e poetit me diktaturën
Hasan Bello

Teknologji

Emotiv EPOC EEG , Tabletat - Ejup Lila



Nga Ramadan Çipuri



Si ta lexojmë 23 qershorin?

Për herë të parë pas 22-vitesh pluralizëm politik, Shqipëria duket se arriti të organizojë zgjedhje brenda një kuadri të kënaqshëm standartesh. Vota dhe vullneti i elektoratit ishte i qartë dhe nuk la hapësirë për debate e konflikte midis liderëve politikë dhe militantëve të tyre.

Ishin zgjedhjet e para që vunë politikën me shpatulla pas muri, qofshin këta të djathtët që humbën, apo të majtët që erdhën në pushtet. Mesazhi ishte i qartë për të dyja palët: “mbaj premtimet të të votoj”. Por, pavarësisht rezultatit, fitorja më e madhe ishte ajo e një elektorati të edukuar, i cili siç të votëbeson, ashtu edhe mund të të ndëshkojë.

Në sistemet demokratike zgjedhjet janë një mundësi që i ofrojnë qytetarit të zgjedh drejtuesit e tij në bazë të vullnetit dhe dëshirës së shumicës. Njerëzit, kur shkojnë të votojnë nuk vendosin instiktivisht, vetëm si një zgjedhjeje e momentit. Vota i ngjan atij vendimit që dikujt i duhet të marrë para se të martohet, kur përballë ka dy alternativa: një kandidate të bukur e jo të mençur dhe një jo aq të bukur, por të zgjuar dhe familjare.

23 qershori tregoi se elektorati shqiptar vepron me përgjegjësi të plotë kur shkon në kutinë e votimit. Duke e menduar si një detyrim moral ndaj vendit të tyre, ka shumë qytetarë që kanë udhëtuar nga qyteti në qytet, vetëm për të shprehur vullnetin e tyre. Gjithashtu, edhe mjaft shqiptar të ardhur nga jashtë kufijve kanë sakrifikuar kohë e para për 23 qershorin.

Përballë peizashit të rezultateve të fundit, mendoj që ka disa mësimet për t'u nxjerrë:

Së pari, rezultatet ishin një leksion për të gjithë ata që nuk i besojnë demokracisë. Besimi i elektoratit mund të fitohet vetëm me një strategji të qartë, kandidatë të besueshëm dhe punë të palodhur. Koha e manipulimeve tashmë ka marrë fund.

Së dyti, pushtetarët ndëshkohen për çdo premtim

të pambajtur apo pakënaqësi të masave. Elektorati nuk mund të manipulohet më me disa shirita të prerë në prag zgjedhjesh. Zbatimi i programeve qeverisëse duhet të shtrihet gjatë gjithë mandatit të votëbesuar.

Së treti, kjo është karakteristikë vetëm për vendin tonë. I d uhet dhënë fund asfaltomanisë së politikanëve. Pavarësisht rëndësisë që infrastruktura ka në zhvillimin e vendit, ajo nuk përbën elementin thelbësor. As “Rruga e Kombit”, as “Tuneli i Elbasanit” e as “Infrastruktura e Shkodrës” e shumë projekte të tjera madhore në infrastrukturë nuk i paraprinë zemërimit të masave ndaj realitetit të pashpresë me të cilin përballeshin çdo ditë. Qeveria e djathtë duhet përgëzuar për të gjitha investimet e bëra në këtë sektor. Por kjo në asnjë mënyrë nuk justifikon pakënaqësinë e popullit përballë shërbimit të munguar në administratën publike e shëndetësi, mungesën e sigurisë në rrugë e banesë, korrupsionin që ka kapluar sistemin e drejtësisë apo gjokat pa sens të policëve rrugorë e bashkiak, që falë klientilizmave të ndryshëm të ngarkojnë makinat në karrotrec, qoftë kjo edhe në periferitë e Tiranës.

Së katërti, në rast humbjeje të zgjedhjeve, sjellja e liderëve politikë duhet të jetë si ajo e kreut demokrat, Sali Berisha, më parë kjo edhe nga Fatos Nano. Por, kjo sjellje nuk është një praktikë e njohur në Shqipëri. Humbja duhet të sjell rinovim dhe ristrukturim të forcave politike në mënyrë që t'i jepet mundësi të resë. Besoj se kjo situatë është një mësim i mirë në të ardhmen edhe për liderin socialist Edi Rama.

Së pesti, duhet kuptuar që Shqipëria nuk është më ai vendi i dalë nga izolimi gati gjysmëshekullor e shqiptarët nuk ngjasojnë më me ato turmat që kacavirreshin nëpër muret e ambasadave të huaja apo që rrezikonin jetën duke u varur nëpër hekurat e anijeve.

Nga Mark Marku



Dyzimi i simbolikës kombëtare



Krijimi i shtetit të ri të Kosovës ka qenë risi sa për marrëdhëniet dhe insitucionet ndërkombëtare, aq edhe për botën shqiptare. Krejt papritur shqiptarët në Ballkan u gjetën para një realiteti politik të ri: ekzistencës së dy shteteve shqiptare në Ballkan. Ky realitet i ri politik ka shtruar menjëherë problemin e parë: ç'raporte do të kenë këto dy shtete me njëri-tjetrin dhe të dyja bashkë me kombin? Prej këtej burojnë shumë pyetje, të cilët shqiptarët për arsye kryesisht politike refuzojnë t'u përgjigjen në këtë moment. Por, pyetjet gjithësesi ekzistojnë dhe të formuluara pak a shumë në këtë mënyrë: Do të ketë dy shtete kombëtare shqiptare në Ballkan apo një shtet të vetëm? A mundet që realiteti politik i krijuar brenda njësisë kombëtare të çojë edhe në realitete të ndryshme kombëtare? Cilën rrugë do të ndjekin në të ardhmen shqiptarët: atë të dy Gjermanive apo rrrugën e Gjermanisë dhe Austrisë? E thënë shkurt, realitetet e reja politike do të çojnë drejt bashkimit apo ndarjes së shqiptarëve?

Këto pyetje u bënë më ngulmuese në momentin kur po themelohej shteti i Kosovës, më konkretisht, në rastin e përcaktimit të simboleve të shtetit të ri. Papritur, shteti i ri duhej të kishte një flamur dhe ky flamur duhej të ishte i ndryshëm nga ai i shtetit shqiptar. Duhej të kishte

një himn dhe ai i ndryshëm nga himni kombëtar. Duhej të kishte një festë dhe ajo e ndryshme nga festa kombëtare. Shteti i ri duhej të kishte simbolet e veta, të cilat nuk mund të ishin simbole kombëtare. Pavarësisht entuziazmit të momentit për shkak të faktit që për herë të parë shqiptarët e Kosovës ndjeheshin të lirë, ky moment ka qenë një goditje e fortë për nacionalistët shqiptarë në Kosovë dhe në Shqipëri. Simbolika e shtetit të ri ishte shumë larg të qenit simboliko-kombëtare dhe nga pikëpamja e nacionalistëve, shteti i ri po e niste jetën e re si shtet pa identitet kombëtar.



Ibrahim Rugova, lideri historik i Kosovës, e kishte parashikuar këtë moment. Largpamës si në gjithçka, ishte munduar që nga pikëpamja simbolike t'i gjente një simbolikë shtetit të ri që po lindte, e cila edhe pse e ndryshme nga simbolika kombëtare shqiptare, ishte një simbolikë identitare. Simbolika e Rugovës kishte lidhje me rrënjët, domethënë

me prejardhjen, por ajo e çonte identitetin kolektiv të shqiptarëve të Kosovës në epokën e ilirëve dhe e lidhte atë me fisin e dardanëve, popullsi ilire që sipas të dhënave historike kishte jetuar në këto territore. Rugova e kishte ekspozuar simbolikën e shtetit të ardhshëm në zyrën e tij presidenciale në Prishtinë dhe ky fakt u komentua shumë ashpër nga kundërshtarët e tij. Ai shumë shpejt

u gjend i akuzuar se po shpikte një simbolikë të re të shtetit të ardhshëm të Kosovës, që i shmangej simbolikës kombëtare shqiptare.

Rezistenca ndaj simbolikës së re është në fakt rezistencë ndaj dyzimit të simbolikës kombëtare të shqiptarëve. Një artific i ri si shteti i krijuar në një territor të caktuar të asaj që shqiptarët e kanë quajtur hapësirë kombëtare, kërkon të ndryshojë simbolikën e një artificiali të vjetër si kombi. Ky dyzim është i vështirë, sepse te shqiptarët artificiali i kombit është krijuar para krijimit të shtetit.

Historiani gjerman Friedrich Meinecke i ndan kombet në dy lloje: në kombe të shtetit dhe kombe të kulturës. Njëri koncept e ka burimin tek Rusoi dhe tjetri tek Herderi “Kombet-shprehet historiani gjerman- ndahen në kombe të shtetit dhe kombe të kulturës, në të tilla që mbështeten mbi një pasuri të caktuar kulturore që është përjetuar bashkarisht dhe në të tillë që mbështeten më së shumti në fuqinë bashkuese të një historie e të një kushtetute të përbashkët politike”¹. Është fare e qartë se shqiptarët bëjnë pjesë në kategorinë e kombit të kulturës. Rilindasit shqiptarë para se të kalonin në përpjekjet për krijimin e shtetit shqiptar, themeluan njësinë kombëtare. Duke u nisur nga gjuha, raca dhe nga traditat e përbashkëta kulturore ata krijuan simbolikën e përbashkët kombëtare, simbolikë që e merrte domethënien nga koha e Skëndërbeut. Është e çuditshme se si ideja kombëtare ka qenë aq e fuqishme te shqiptarët, sa ajo ka sfiduar edhe religjionin. Della Rowa pohon jo pa të drejtë, se çështja kombëtare, d.m.th. çështja e pavarësisë së vendit dhe e shkallës së besnikërisë ndaj kombit të çdo pjesëtari të saj ka përshkuar çdo shfaqje të jetës shqiptare që nga gjysma e shekullit XIX e këtej. “Pikërisht nga këndvështrimi i nacionalizmit dhe aspiratës për një pavarësi kombëtare të plotë, fetë shqiptare i janë nënshtruar shpeshherë gjykimit të shqiptarëve, a thua se arsyeja e ekzistencës së tyre duhej të ishte mbështetja e

patriotizmit të besimtarëve të tyre”². Është për t’u çuditur se si fetë në Shqipëri janë detyruar t’i përshtaten një rrethane të tillë, shpeshherë duke iu kundërvënë karakterit universal të tyre.

Krijimi i shtetit shqiptar në vitin 1912 ishte bashkimi i pjesëshëm i njësisë kombëtare me njësinë politike, për shkak se shteti i ri shqiptar shtrihej vetëm në diçka më shumë se një të tretën e territorit të bashkuar nga shqiptarët dhe kishte si shtetas të tij më pak se gjysmën e shqiptarëve që banonin në Ballkan. Pavarësisht kësaj, shqiptarët jashtë kufijve të shtetit shqiptar vazhdonin ta konsideronin veten pjesë të kombit shqiptar dhe nga pikapamja identitare e gjenin përfaqësimin e tyre pikërisht te shteti shqiptar dhe te simbolika e tij. Nga ana e tij, shteti shqiptar, edhe pse i dobët nuk ka refuzuar ta pranojë atributin e përfaqësimit të shqiptarëve në botë. Le të kuptojmë faktin se në jetën politike dhe parlamentare të viteve 1920-1945 elementi shqiptar i Kosovës ka patur të drejtën e përfaqësimit dhe ka qenë mjaft aktiv.

Ky përshkrim i shkurtër historik është i mjaftueshëm për të kuptuar se sa domethënie ka simbolika kombëtare tek shqiptarët dhe sa e vështirë është dyzimi i kësaj simbolike. Megjithatë, jemi pikërisht në një moment të tillë përpjekjesh për dyzim. Historiani zviceran Altermaht në librin e tij “Etnonacionalizmi në Evropë” duke shtruar problemin në fjalë, sjell si argument thënien e një historiani hungarez (Jenë Szucs), sipas së cilit “Rrënjët dhe plebishiti janë simbole mjaft të vjetra tipash të ndryshëm të ndërgjegjës kombëtare. Rrënja duket të jetë më organike e më e fuqishme, e megjithatë ajo është më e pasigurta, ndërsa plebishiti duket se është më i pasigurtë e megjithatë duket se është më i fuqishëm”³. Nëse i konsiderojmë sadopak të vërteta përfundimet e

2 Roberto Maroco dela Roka. Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944, faqe 7. Shtepia botuese “Elena Gjika”. Tirane 1994.

3 Cit. i cituar Urs Ahteramat. “Etnonacionalizmi në Evropë”. Phoenix, Tiranë 2002.

1 Friedrich Meinecke: “Borgjezia botërore dhe shteti kombëtar”. Mynih, F. 68. 1969.

historianit të mësipërm atëherë mund të themi se sado artificiale të duken simbolet e shtetit të ri të Kosovës, ato mund të fitojnë mbi simbolet e vjetra kombëtare. Nëse kështu, atëherë dalim në një problem tjetër edhe më të mprehtë dhe që pakkush guxon ta përmendë në hapësirat tona publike dhe politike: a jemi para synimeve për të krijuar një komb të ri në Ballkan, kombin kosovar? Kjo do të thotë përpjekje për krijimin e dy kombeve të diferencuar shqipfolëse në Ballkan.

Nëse nisemi nga treguesit e politikës ndërkombëtare në Ballkan, mund të themi se po, ka aktorë politikë ndërkombëtarë që janë të interesuar që shtetit të ri të Kosovës t'i krijojnë edhe një komb të ri kombin kosovar. Presioni ndërkombëtar është i madh edhe për shkak të rrezikut fantazmagorik të krijimit të së ashtuquajturës "Shqipëri e madhe", realitet fiktiv i krijuar nga serbët dhe që e ka filluesën tek libri i Vladan Gjerogjeviçit "Shqipëria dhe Fuqitë e mëdha", por ndoshta edhe më parë.

Nëse nisemi nga përvoja historike mund të themi se një gjë e tillë edhe mund të ndodhë. Në histori kemi raste kur shteti ka krijuar kombin (rasti i SHBA, Francës), por edhe rastin kur kombi ka krijuar shtetin (Gjermania, Italia, Zvicra).

Nëse nisemi nga treguesit konkretë, ato ekzistojnë. Simbolika është një prej këtyre vepruesve konkretë. Natyrisht duhet kuptuar krijimi i simboleve të reja, që ndryshe nga ato të një shteti tjetër për shtetin shqiptar ka qenë i domosdoshëm. Problemi qëndron në faktin se kjo simbolikë është krejtësisht e re dhe qëllimshëm pa asnjë referencë kombëtare. Ndoshta e vetmja lidhje është ngjyra: bluja e qiellit e ka gjithësesi një lidhje me shqiponjën. Pierre Bourdieu në librin e tij "Gjuha dhe pushteti simbolik" thotë: "Lufta në lidhje me identitetin etnik, domethënë lufta ndaj veçorive të lidhura me origjinën (emblemave dhe shenjat) dhe shenjave të tjera që përfaqësojnë atë si gjuha,

janë një rast i veçantë i luftës për rregullime, i luftës për monopolin e pushtetit për të bërë të besosh dhe të shikosh, për të bërë të njohësh dhe të rinjohësh, për të vendosur përkufizim legjitime të ndarjes së botës sociale e nëpërmjet kësaj për të bërë e ribërë grupet..."⁴.

Dyzimi i simbolikës kombëtare është hapi i parë i krijimit të dy realiteteve dhe i dy grupeve shoqërore me karakteristika të dallueshme. Përpjekje të tjera janë shfaqur nga grupe dhe elementë të caktuar. P.sh. disa individë dhe grupe (për momentin të kufizuara), kanë filluar të hedhin idenë se gjuha e Kosovës dhe gjuha e Shqipërisë nuk duhet të jenë të njëjta. Raste të tjera ku më shumë e ku më pak shfaqen here pas here. Për momentin, retorika kombëtare është ligjërimi mbizotërues dhe shqipja është ende një shpend i rrezikshëm. Nuk e dimë ende edhe për sa kohë do të jetë e tillë.



4 Perre Bourdieu. "Langage et pouvoir symbolique". F 282-283. Editions Fayard. Paris 2001.

Nga Emirjon Senja



Aritmetika e kutive, PS mori votuesit e rinj, PD-në e gërryen aleatët dhe LSI-ja

Si u ndanë votat e 200 mijë votuesve të rinj? Ku shkuan votat e munguara të PS-së? Cili ishte roli i LSI-së në fitoren e të majtës?

Zgjedhjet nxorrën një rezultat të qartë dhe një mesazh të fortë ndaj maxhorancës së re, duke i dhënë asaj 84 vota në Kuvend. Tepër i qartë ishte mesazhi edhe për opozitën e nesërme, e cila u tkurr keqazi në vetëm 56 kartonë në parlamentin e shtatorit. Rritja e fortë e LSI-së në këto zgjedhje dhe devijimi i votave demokrate nga PD-ja tek aleatët e saj janë treguesit e dukshëm të këtij rezultati, i cili flet qartë nëpërmjet shifrave, por jo aq mbi shkaktarët e vërtetë të tij.

LSI 2.5 fishoi votat

Çelsi i këtij rezultati është Lëvizja Socialiste për Integrim, e cila me 17 deputetët e saj i mundëson kësaj maxhorance numrin e artë të 84 votave në parlament. Të dhënat zyrtare tregojnë se LSI bëri një kapërcim të forte, ku e rriti me thuajse 2.5 herë numrin e mbështetësve të saj në kuti krahasuar me zgjedhjet e vitit 2009, kur ajo ishte në një koalicion të vetin, veç Partisë Socialiste. Nëse në 2009, LSI mori rreth 73 mijë vota. Në zgjedhjet e qershorit, ajo siguroi plot 180 600 të tilla duke marrë plot 107 640 vota plus.

PD-në e gërryen edhe aleatët

Partia Demokratike e këtyre dy legjislativave që mbyllëm ishte një parti që mbështetej fortë tek aleatët, por duket se kësaj radhe i kishte besuar më shumë se sesa duhej besnikërisë së elektoratit të saj. Kjo bëri që shumë vota demokrate të kalonin te partitë e tjera të djathta, duke pakësuar numrin e deputetëve me siglën e PD-së në Kuvend. Partia Republikane është aleati kryesor që ka përfituar më shumë nga elektorati demokrat në këto zgjedhje, duke nxjerrë tre deputetë nga listat e saj dhe kryetarin Fatmir Mediu nga lista e Partisë Demokratike. Përpos votuesve të saj tradicional, duket se PR-ja mori edhe votat e demokratëve të zhgënjyer dhe mërzhitur me qeverisjen. Nga rezultati vërehet se një pjesë e mirë e tyre kanë menduar që votën ta mbajnë djathtas, por duke votuar një parti edhe më tepër të djathtë, si PR. Kjo shpjegohet edhe me rritjen e beftë të votave për partitë e tjera të djathta gjatë këtyre zgjedhjeve. Partitë e spektrit të djathtë morën plot 63 mijë vota, më shumë në 23 qershor, krahasuar me zgjedhjet e vitit 2009. Një pjesë e mirë e këtyre votave janë

pikërisht nga të djathtët e zhgënjyer prej PD-së.

Por nëse kalimi i demokratëve tek PR-ja mund të quhet i natyrshëm, nuk mund të shpjegohet, të paktën logjikisht, kalimi i një pjese të votave PD-iste te Lëvizja Socialiste për Integrim.

Ndryshe nga demokratët tradicional të mërzhitur me PD-në, demokratët e përfshirë në administratë janë treguar më shumë pragmatistë se sa idealistë. Pretendimet mbi këtë rritje të madhe të LSI-së në këto zgjedhje janë të shumta, por kapërcimi i madh i demokratëve nga partia e tyre te një parti më e majtë se sa edhe vetë PS-ja mund të shpjegohet duke nisur nga shkaqet tepër pragmatike. LSI ishte një parti që vinte nga pushteti dhe anëtarët e saj kishin punuar për të paktën katër vjet bashkë me administratën demokrate. Siguria që kjo parti i jep mbështetësve të saj dhe pritshmëria që sido që të përfundojnë zgjedhjet, LSI do të ishte në pushtet, ka bërë që edhe demokratët e administratës të votojnë partinë e Metës me premtimin e marrë se do të ruanin vendin e punës në qeverisjen së nesërme.

PS mori votat e votuesve të rinj

Çfarë ndodhi me PS-në? Të dhënat e mbledhura nga KZAZ-të e shpërndara nëpër 12 qarqet e vendit tregojnë se kryesuesja e koalicionit të majtë, Partia Socialiste mori në zgjedhjet e 23 qershorit rreth 0.6 përqind më shumë vota krahasuar me rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2009.

Si fituesja e këtyre zgjedhjeve, PS ka dalë me rreth 92 mijë vota plus, krahasuar me 2009. Në raport

me numrin e deputetëve ndërkohë, del që PS është në të njëjtat shifra. Pra, pavarësisht numrit më të madh të votave, PS nuk ka mundur të rrisë numrin e deputetëve duke ngecur në 64 . Ndryshe nga partitë e tjera të vogla, të majta dhe të djathta, PS ka marrë votat e elektoratit të saj, madje ka thithur pjesën më të madhe të votuesve të rinj.

Një fakt tjetër i rëndësishëm që ndikoi në rritjen e numrit të votave

për PS-në është ardhja masive e emigrantëve për të votuar. Strukturat e PS-së janë më të forta në vendin ku gjenden pjesa më e madhe e migrantëve shqiptarë, si Greqia dhe Italia. Të ardhurit përtej kufirit vetëm për të votuar gjatë ditës së zgjedhjeve arrin në rreth 60 mijë persona.



Zgjedhjet e 23 qershorit në shifra *Gjithësej, dyqind mijë votues plus*

Partia Socialiste

PS 2009- 622 mijë vota

PS 2013- 713 800 vota

PS ka marrë 91 800 vota të reja

Partia Demokratike

PD 2009- 611 040 vota

PD 2013- 526 320 vota

PD doli me 84 720 më pak nga 23 qershori

Lëvizja Socialiste për Integrim

LSI 2009- 72 960 vota

LSI 2013- 180 600 vota

LSI mori 107 640 vota plus në 23 qershor

Të tjera djathtas

2009- 127 680

2013-190 920 vota

Vota plus: 63 240

Zgjedhjet, Shqipëria kaloi klasën ?

Raporti i vëzhguesve ndërkombëtar flet për zgjedhjet e zhvilluara në klimë paqësore, transparente dhe të besueshme

Shqipëria ka zhvilluar 13 palë zgjedhje të përgjithshme dhe lokale që prej vendosjes së pluralizimit politik. Nga këto, në të paktën dy raste janë hasur kundërshtime të mëdha të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm politik duke vënë kështu në dyshim edhe legjitimitetin e Kuvendit.

Zgjedhjet e 26 majit 1996 janë njolla e zezë e parlamentarizmit shqiptar. Presioni mbi opozitën bëri që ajo të detyrohej të tërhiqej nga gara dhe kutitë “të mbusheshin” duke nxjerrë një parlament me vetëm 10 deputetë opozitarë. Zgjedhjet e vitit 2001 u fajësuan për fenomenin e “Dushkut”, ku për shkak hapësirave që lejonte ligji dhe trukeve elektorale, mazhoranca e atëhershme arriti të nxjerrë 10 deputetë nga një fshat i Lushnjës me të njëjtin emër.

Duket se gjërat ndryshuan përmirë gjatë zgjedhjeve që sapo mbyllëm. Në raportin paraprak të OSBE-ODIHR-it, vëzhguesit ndërkombëtar i vlerësuan ato si konkurruese, të zhvilluara në një klimë paqësore dhe në një proces të besueshëm. “Ne theksojmë me kënaqësi që situata gjatë fushatës elektorale ishte e paqtë, duke lejuar

kandidatët që të zhvillonin aktivitetet për të prezantuar programin e tyre dhe për të diskutuar çështje me interes për vendin. Krahasuar me zgjedhjet e kaluara, procesi i numërimit të votave ishte i shpejtë dhe transparent”, theksohet në raport. Aty shtohet se problemet teknike dhe mosbesimi i ndërsjellë të partive tek njëra-tjetra nuk uli besimin e publikut tek procesi zgjedhor.

Gjithashtu, raporti paraprak vlerëson se procesi ishte i besueshëm dhe transparentë me pjesëmarrje më të larta të votuesve gjatë viteve të fundit, duke rezultuar me një fitore të qartë të bllokut opozitar.

3 ditë zgjati procesi i numërimit të fletëve të votimit gjatë zgjedhjeve të 23 qershorit duke shënuar

kështu një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me zgjedhjet e vitit 2009, në cilin kontestimet e shumta vonuan numërimin

Krahasuar me zgjedhjet e kaluara, procesi i numërimit të votave ishte i shpejtë dhe transparent

VOTE

Akademikë vs. biznesmenë

Në parlamentin e ri do të hyjnë 31 biznesmenë, 20 prej të cilëve e kanë për herë të parë. Partitë tradicionale futën në listat e tyre edhe një numër të konsiderueshëm kandidatë që vijnë nga fusha akademike.

Listat e shpallura nga partitë politike para zgjedhjeve, rrjedhimisht edhe rezultati i tyre tregojnë se partitë kanë hequr dorë nga politikanët e mirëfilltë, duke ia prezantuar publikut emra, të cilët jo domoshmërisht kanë një të shkuar të gjatë politike në strukturat e tyre. Duket se partitë tradicionale janë përpjekur që në lista të afrojnë më shumë emra të njohur të fushës së arsimit apo me kontribute të rëndësishme në mjekësi, ndërkohë që partitë e cilësuar si të vogla kanë preferuar t'i sfidojnë të mëdhënjtë duke emëruar në krye të listave të tyre biznesmenë dhe figura të forta. Kjo strategji rezultoi e suksesshme, duke parë numrin e votave të marra dhe deputetëve të gjeneruar prej tyre.

Biznesmenët

Parlamenti i ri që pritet të mblidhet për herë të parë në shtator, do të ketë plot 31 biznesmenë në gjirin e tij. Ky është numri më i madh i biznesmenëve që janë futur ndonjëherë në Kuvend. Plot 20 prej këtyre zgjidhen për herë të parë, ndërsa 11 të tjerë kanë qenë edhe gjatë legjislaturës që po mbyllet. Por, si ndahen deputetët-biznesmenë midis partive? Partia Socialiste ka 14 biznesmen, numri më i madh i deputetëve-biznesmenë në Kuvend. Të tillë janë: Fidel Ylli, Anastas Angjeli,

Tom Doshi, Paulin Stërkaj, Rakip Suli, Artan Gaçi, Parid Cara, Dashamir Peza, Majlinda Bufi, Ilir Xhakolli etj. Ndërkohë, në Partinë Demokratike rezultojnë 5 deputetë-biznesmenë, si Roland Keta, Astrit Veliaj, Kozma Dashi, Gjovalin Kadelli dhe Bedri Hoxha.

Raporti i deputetëve-biznesmenë rritet kur kalojmë nga partitë tradicionale tek ato të konsideruara të vogla. Kështu për shembull, nga 16 deputetë që ka Lëvizja Socialiste për Integrim, 6 prej tyre ose rreth 40 për qind, janë biznesmenë. Të tillë janë: Lefter Koka, Agron Çela, Piro Kapurani, Përparim Spahiu, Shkëlqim Selami dhe Gledion Rehovica. Tek PDIU ndërkohë, përveç kryetarit Shpëtim Idrizi, katër deputetët e tjerë vijnë nga fusha e biznesit. Omer Mamo është fitues në Fier. Ai merret me ndërtim dhe tregti të karburanteve. Aqif Rakipi ka investuar në restorante dhe lojëra fati. Dashamir Tahiri, deputeti që del sërish nga qarku i Vlorës, është investitor në fushën e ndërtimit. Tahir Muhedini ka investuar në ndërtim dhe hoteleri.

“20 biznesmenë të rinj hyjnë në Kuvendin e Shqipërisë si rezultat i zgjedhjeve të 23 qershorit. Bashkë me 11 biznesmenët e tjerë ekzistues, numri i atyre që vijnë nga fusha e sipërmarrësve shkon plot 31”

Akademikët

Ashtu si edhe biznesmenët, partitë kanë zgjedhur të fusin në lista një numër jo të vogël kandidatësh për deputetë, individë që vijnë nga auditorët. Një pjesë e tyre janë trashëguar nga lista e vitit 2009, ndërsa nuk mungojnë emrat e rinj si: Eleini Qirici dhe Gjergji Papa në Korçë, Liliana Elmazi në Vlorë apo Arbiola Halimi në Elbasan. Të trija ato janë emrat e rinj të PD-së që vijnë nga fusha akademik. Në listën e PS-së ndërkohë spikasin Evis Kushi, Milena Harito dhe Mimoza Hafizi, të cilat gjithashtu vijnë nga auditorët e universiteteve. Të ardhur nga auditorët janë edhe Vasilika Hysi, Ermonela Felaj, Eglantina Gjermani, të cilat këtë e kanë mandatin e dytë.

“16 akademikë do të ulen në Kuvendin e Shqipërisë në shtator. Tetë prej tyre hyjnë rishtazi”

“Partitë tradicionale janë përpjekur të kombinojnë biznesmenët me prurjet e reja nga fusha akademike, gjë e cila nuk ka ndodhur tek partitë e vogla. Ato janë mbështetur kryesisht tek biznesmenët dhe figurat e forta”

Të munguarit e mëdhenj

PD nuk do të ketë në parlament Leonard Demin, Viktor Gumin, Ilir Rasmajlin etj., kurse PS-së do t'i mungojnë Arben Malaj, Aldrin Dalipi, Et'hem Ruka etj. E djathta pati humbja të thellë në zgjedhje. Kjo duket se do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në cilësinë e opozitës së nesërme, ndryshe nga të munguarit e të majtës, ku pushteti do të fashisë edhe qejfmbetjet gjatë hartimit të listave. Partisë Demokratike do t'i mungojnë plot 30 deputetë nga grupi i tanishëm, ndërsa Partisë Socialiste do t'i mungojnë 14 deputetë.

Një pjesë e tyre nuk u futën fare në lista ndërsa, disa të tjerë, kryesisht nga Partia Demokratike ose ishin nga fundi

i saj ose në pjesën e diskutueshme. Përpos deputetëve që nuk iu "rinovua" mandati i marrë në 2009, prej të ikurve ka emra të cilët kanë qenë një zë i rëndësishëm i parlamentarizmit në vend. Për shembull, nga e majta spikasin emra si: Arben Malaj dhe Et'hem Ruka. Gjatë opozitës 8-vjeçare të Partisë Socialiste, Malaj ishte një ndër zërat më profesionist në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave në Kuvend, aty ku gatuhën ligjet që kanë të bëjnë me politikën ekonomike, të cilat më pas i paraqiten Kuvendit për miratim. Nga ana tjetër, Ruka ka qenë prej vitesh kryetar i Komisionit të Punës dhe i Çështjeve Sociale në Kuvend. Para vitit 2005,

gjatë qeverisjes së majtë, kur PS ishte në opozitë ishte ministër arsimit. Albert Çaci, Marko Bello dhe Aldri Dalipi janë gjithashtu deputetë me disa mandate të marra në legjislaturat e kaluara, të cilët nuk do të ulën sërish në shtator në Kuvend.


Të munguarit e PD-së janë edhe më tepër si në sasi ashtu edhe në "cilësi". PD-së i ikin një pjesë e gardës së vjetër si Jemin Gjana, Leonard Demi apo Ilir Bano që kanë qenë edhe gjatë viteve të opozitës 1997-2005, por edhe disa të ardhur rishtaz më KOP-in, siç është për shembull Enkelejd Alibeaj.

Deputetët që nuk ulen më në Kuvend në shtator

Të munguarit e PS-së



Të munguarit e PD-së



Kush janë rishtarët e parlamentit të ri?

Cili është profesioni, kohëzgjatja e angazhimit në politikë, arsimi dhe lidhja me zonat nga ku janë zgjedhur?

Ata janë 43. Do të betohen për herë të parë si deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Shumica janë anonimë për publikun e gjerë, por me njohje të rëndësishme në ambientin lokal. Të tjerë kanë mbajtur poste në parti, por nuk kanë qenë asnjëherë deputet. Për shkak të angazhimit të shkurtër në politikë, pjesë e tyre mund të cilësohen edhe si “axhami” të politikës shqiptare, por që luajtën një rol të rëndësishëm në mbledhjen

e votave për partitë respektive, të cilat i kandiduan.

Qarqet që kanë numrin më të madh të emrave të rinj janë ai i Fierit me pesë emra dhe Qarku i Korçës me katër emra. Ndërkohë, partitë e mëdha janë treguar më konservatore për sa i përket emrave të rinj në qarqe, si Tirana dhe Elbasani. Dy janë grupet kryesore që dominojnë në listat e deputetëve të rinj të secilës parti: Grupi i parë është ai i biznesmenëve, të

cilët kanë një ndikim të rëndësishëm në lokalitete, ndërsa grupi i dytë dominues janë ata që vijnë nga fusha akademike.

Kush janë deputetët që ulen për herë të parë në Kuvend? Nga vijnë ata? Çfarë profesioni dhe arsimi kanë? Si edhe cilat janë lidhjet e tyre me zonat dhe banorët, të cilët do të përfaqësojnë në Kuvendin e ri?

Më poshtë gjenden profilet e pjesës më të madhe të deputetëve të rinj të Kuvendit:



Evis Kushi-PS



Dekania e Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Elbasanit ishte ndër emrat e prezantuar herët nga vetë kreu i PS-së, si pjesë e skuadrës së Rilindjes. E renditur në vendet e para të listës së Qarkut të Elbasanit, ajo do të ishte një ndër të paktët emra të rinj të PS-së në këtë rajon. Evis Kushi është e martuar dhe nënë e dy fëmijëve. Deputetja e PS-së ka mbaruar studimet në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës. Studimet doktorale i ka përfunduar në Britaninë e Madhe. Mban titullin shkencor Profesor i asociuar.

Luan Duzha-Partia Republikane



Kryesuesi i listës së Partisë Republikane për Qarkun e Elbasanit ishte ndër surprizat e kësaj force politike në këtë rajon. Deri para kandidimit si deputet në listën e PR-së, Duzha ka qenë drejtor i Drejtorisë Rajonale të Mjedisit në Qarkun e Elbasanit. Është banor i Cerrikut, me profesion ekonomist, detyrë që ka mbajtur për disa vite me rradhë edhe në bashkinë e këtij qyteti. Duzha është i afërm i kryetarit aktual të Bashkisë së Cerrikut.

Alfred Peza-PS



Ishte një ndër emrat e parë të prezantuar nga Kryetari Edi Rama si kandidat i PS-së në Qarkun e Elbasanit. Gazetari i njohur me një karrierë 20 vjeçare, zhvilloi një fushatë intensive në zonën e prejardhjes së tij, Peqinin duke përmbysur edhe rezultatin në favor të Partisë Socialiste. Peza është i martuar dhe babai i dy fëmijëve, një vajze dhe një djali. Pritet që të jetë një ndër zërat më të rëndësishëm të maxhorancës së re në Kuvend.



Eleina Qirici-PD

Pedagogia e Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin “Fan Noli” të Korçës, e cila është njëkohësisht edhe zëvendëssektore. Ajo ishte kandidatja nr.2 e Partisë Demokratike në këtë qark. E angazhuar edhe më parë në Forumin e Gruas në këtë parti, Qirici do të jetë

një ndër emrat e rinj që do të përfaqësojë pjesën qytetare korçare në Kuvend.



Ylli Ziçishti-PS

Mjeku i Devollit do të ishte deputeti nr.6 i PS-së në Qarkun e Korçës. 63-vjeçari ka një karrierë të gjatë në fushën e mjeksisë, ndërsa deri para se të kandidonte për deputet si pjestarë i listës së PS-së ka qenë drejtor i urgjencës kirurgjikale në QSUT. Ziçishti është i martuar dhe babai i një vajze.



Piro Kapurani-LSI

Korçari 45-vjeçar ishte renditur i pari në listën e LSI-së në këtë Qark, duke siguruar një numër rekord votash që kjo parti ka marrë ndonjëherë në Korçë (14 553 vota). Kapurani njihet si një ndër biznesmenët më aktiv të këtij Qarku duke shtrirë aktivitetin e tij në fusha të ndryshme, siç janë transporti, importi dhe eksporti i mallrave industrial dhe ushqimeve, shitja me shumicë i veshjeve si edhe aktivitete të ndryshme në shërbime dhe pasuri të paluajtshme.



Ilir Xhakolli-PS

Kjo është hera e dytë që pogradecari e provon për të fituar një vend në Kuvendin e Shqipërisë nën siglën e Partisë Socialiste. Në vitin 2009 ai ishte renditur nr.12 duke pasur shanse zero, ndërsa në zgjedhjet e 23 qershorit, Xhakolli e gjen veten të renditur si nr. 5 në qarkun e Korçës, nga i cili PS nxorri gjashtë deputetë. Biznesmeni me origjinë nga Mokra, është njëkohësisht edhe Kryetar i PS-së për Pogradecin. Kompania në pronësi të tij numëron një sërë aktivitete, si ndërtim, import-eksport i mallrave ushqimorë dhe industrial si edhe të karburanteve.



Artur Bushi -PS



Artur Bushi është deputeti nr.7 i Partisë Socialiste në Qarkun e Durrësit. Për t’u bërë deputet, 34-vjeçarit iu desh të sakrifikoje postin e kryetarit të Komunës Thumanë të Fushë-Krujës, të fituar në zgjedhjet e vitit 2011. Në fillim të viteve ’90, ai emigron në Itali për t’u rikthyer më pas duke përfunduar në vitin 2010 studimet për drejtësi në Universitetin e Tiranës. Aktualisht, është duke kryer studimet në degën e historisë në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, në Universitetin e Tiranës



Albina Deda-PD



Mjekja nga Rrësheni ishte renditur e treta në listën e Partisë Demokratike për Qarkun e Lezhës. Deda është e martuar dhe nënë e tre fëmijëve. Ka mbaruar Fakultetin e Mjeksisë në fillim të viteve ’90 në Universitetin e Tiranës si edhe studimet “master” po në këtë fushë. Deri para se të kandidohej nën siglën e PD-së, ajo ka mbajtur postin e drejtoreshës së Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor në Qarkun e Lezhës

Parid Cara-PS



Biznesmeni, 37 vjeç i ikur nga Shqipëria që adoleshent, rikthehet duke marrë një vend në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë si deputet i qarkut të Tiranës, për të përfaqësuar vendlindjen e tij, Kavajën. Cara është një nga kandidatët e hershëm të prezantuar nga Rama dhe bashkë me kryetarin aktual të bashkisë së Kavajës, Elvis Rroshin, duket se kanë ndikuar ndjeshëm për ndryshimin e rezultatit në këtë zonë, të njohur si bastion i PD-së. Është babai i dy fëmijëve dhe që prej fillimit të viteve '90 ushtron aktivitetet si biznesmen në Bolonja të Italisë.

Jorida Tabaku-PD



Jorida Tabaku është nënkryetaria e Bashkisë së Tiranës. Ajo pati rol të rëndësishëm në imazhin e stafit të kandidatit Basha. Në zgjedhjet lokale të majit 2011 ishte renditur e shtata në listën e Partisë Demokratike, duke e siguruar kështu mandatin që pa u zhvilluar zgjedhjet. Tabaku ka mbaruar studimet në Fakultetin e Ekonomisë në Tiranë. Ka bërë masterin mbi qeverisjen lokale në Britaninë e Madhe. Mban gradën shkencore "Doktore shkencash."

Halim Kosova-PD



Halim Kosova është mjek. Prej duarve të tij kanë lindur qindra foshnje. Tani, ai ulet për herë të parë në Kuvendin e Shqipërisë. Ai mbajti për pak muaj postin e ministrit të Shëndetësisë kur LSI-ja doli nga koalicioni qeverisës me PD-në. Bashkë me Visar Zhitin, (i cili nuk mundi të fitonte), ata u cilësuan si kandidatët që nuk vinin nga radhët e kontribuesve të drejtpërdrejtë në PD, por që do të ndikonin në marrjen e votës përtej militantëve të partisë.

Rakip Suli-PS




Është ndër emrat e rinj të listës së deputetëve të PS-së, por jo i panjohur edhe më parë në minibashkinë nr.11 dhe zonën e Kamzës, të cilën mbuloi në këto zgjedhje. Biznesmeni 56-vjeçar kandidoi nën siglën e Partisë Socialiste edhe në zgjedhjet e vitit 2011 për kryetarin e Bashkisë së Kamzës, duke humbur me një diferencë prej rreth 2 900 votash përballë kryetarit në fuqi, Xhelal Mziu. Suli, bashkë me vëllezërit e tij ushtron aktivitetet në biznesin e tregtimit të

materialeve të ndërtimit, biznes i nisur që prej vitit 1996


Pjerin Ndreu-PS



Pukjani ulet për herë të parë në Kuvendin e Shqipërisë, por është një emër tepër i dëgjuar, sidomos gjatë qeverisjes së shkuar socialiste. Ka mbajtur poste drejtuesve në Policinë e Shtetit, por njihet edhe si finalizuesi i aksionit antiskaf në fillim të viteve 2000. Ndreu pati nën patronazh zonën e Kamzës gjatë zgjedhjeve të 23 qershorit. Ka studiuar në Akademinë e Rendit. Është i martuar dhe baba i tre fëmijëve, dy djem dhe një vajzë.




Tahir Muhedini-PDIU



Biznesmeni i rritur në lagjen “Ali Demi” në Tiranë, është iniciatori i ngritjes së një partie për të përfaqësuar interesat e komunitetit çam në Shqipëri, me siglën Partia për Drejtësi dhe Integrim (PDI). Pas kalimit të Shpëtim Idrizit në krye të saj, partia ndërroi edhe emrin në Partia për Drejtësi, Unitet dhe Integrim. Muhedini ushtron aktivitetet duke investuar në pasuri të paluajtshme si edhe eksport-import të mallrave të ndryshëm industrial dhe ushqimor. President i nderit i PDIU-së mori mandatin në kryeqytet duke iu bashkuar katër mandateve të tjera çamë, përfshirë edhe kryetarin Idrizi, i cili hyri me listën e Partisë Demokratike.

Klajda Gjoshja -LSI



Është një nga deputetet më të reja të Kuvendit të Shqipërisë. Ka fituar të drejtën për të qenë deputete e Qarkut të Tiranës. Emri i saj ishte vendosur i dyti në listën e Levizjes Socialiste për Integrim, pas kryetarit Ilir Meta. Gjoshja ishte zëvendësministre e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta gjatë legjislaturës së kaluar. Ndërkohë mban postin e Kryetares së Levizjes së Gruas për Integrim, pjesë e LSI-së. Gjithashtu, Gjoshja është edhe nënkryetare e LSI-së.

Keltis Kruja -PD



Deri në momentin e futjes së emrit të tij në listën e kandidatëve për deputet për Partinë Demokratike në Tiranë, Kruja mbante postin e prefektit të këtij Qarku. I lindur në Tiranë, aktualisht 34 vjeç, me një të shkuar aktive në shërbime të Partisë Demokratike, Keltis Kruja është një ndër emrat që ka mbështetjen e fortë të liderit Sali Berisha. Kruja është diplomuar për Drejtësi. Emri i tij ishte listuar i parafundit edhe në zgjedhjet e vitit 2009 si kandidat për deputet. Tashmë e gjen veten në Kuvendin e Shqipërisë duke qenë i renditur si i dhjeti.

Ylli Shehu-PR




Është një nga emrat aspak të lakuar, deri në ditën kur u listua si i pari i Partisë Republikane për Tiranën, duke marrë parasysh edhe faktin që kryetari Fatmir Mediu garonte nën siglën e PD-së në Korçë. Shehu është jurist në profesion, por është diplomuar edhe në ekonomi. Me prejardhje nga Kukësi, Shehu doli deputet kryesisht nga votat e marra në zonën Kamzës deri në Domje të Kavajës. Zhvilloi një fushatë të qetë dhe efektive duke arritur të sigurojë marrjen e mandatit që pa mbaruar ende numërimi i të gjitha kutive të votimit.

Milena Harito-PS



Pedagogia e Fakultetit të Shkencave së Natyrës ishte ndër imazhet e reja që dolën në podiumin e Partisë Socialiste disa muaj para zgjedhjeve, me qëllim denoncimin sipas tyre të politikave të ndërmarra nga qeveria. Për disa vite, ajo ka qenë e punësuar në Francë në fushën e telekomunikacionit, duke drejtuar disa drejtori të France Telecom-Orange. Harito. E martuar, nënë e dy fëmijëve, ka përfunduar studimet për informatikë në Universitetin e Tiranës. Ka gradën shenore “Doktore e shkencave” dhe aktualisht është pedagoge e jashtme në Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

Mimoza Hafizi-PS



Shkodrania e diplomuar për fizikë është një ndër emrat e rinj në Kuvendin e Shqipërisë që vijnë nga jeta akademike. Hafizi mban titullin shkencor Profesor i asociuar. Edhe deri në momentin e kandidimit ka qenë në pozicionin e shefës së Departamentit të fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Hafizi ishte angazhuar edhe më parë në Partinë Socialiste duke iu kundërvënë edhe kreut të saj Rama për mos kandidimin në zgjedhjet e vitit 2009.

Voltana Ademi-PD



Profesoresha e informatikës zgjidhet për herë të parë si deputete, por nuk vjen rishtaz në politikë. Gjatë periudhës 2003-2007 ajo ka qenë nënkryetare e Bashkisë së Shkodrës dhe anëtare e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike. Së fundmi, Ademi ka qenë prefekte e qarkut të Shkodrës. Është e martuar dhe me një fëmijë.



Helidon Bushati-PD

Shkodrani ishte për disa muaj drejtor i QSUT-së deri në momentin që kandidoi për deputet në Qarkun e Shkodrës. I diplomuar në studimet “Bachelor” dhe në studimet “Master” në fushën e shkencave politike, ai ka mbajtur disa poste drejtuese edhe në ministri të tjera. Bushati ka qenë drejtor i përgjithshëm i burimeve dhe modernizimit në Ministrinë e Mbrojtjes. Gjatë periudhës gusht 2007–gusht 2010, ishte drejtor i Administrimit të pronës publike, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe të Energjetikës.

Agron Çela-LSI



Biznesmeni i njohur shkodran ka investuar në fusha të ndryshme, të cilat fillojnë nga turizmi deri

tek pasuritë e paluajtshme. Çela është ndër aksionerët kryesorë të kazonës më të madhe në vend. Që nga janari i këtij viti, Çela është njëkohësisht edhe presidenti i ekipit të futbollit Vllaznia. Deputeti i Levizjes Socialiste për Integrim, në emër të të cilit janë të regjistruara edhe shumë biznese të tjera në të gjithë vendin angazhohet për herë të parë në politikë.



Vexhi Muçmata-PS



Vexhi Muçmata është prokuror. Ai është 58 vjeç. Muçmata ishte një ndër emrat e parë të lakuar si kandidat i Partisë Socialiste në Qarkun e Kukësit. Me karrierë të gjatë në fushën e drejtësisë, Muçmata u rendit si i pari i socialistëve në një qark ku rezultati i zgjedhjeve të 2009-ës i nxirrte në dezavantazh. Që prej fillimit të viteve '90, ai ka mbajtur një serë postesh në organin e akuzs dhe në KLD. Para se të kandidonte për PS-në, ai ushtronte detyrën e prokurorit të Tiranës.



Kozma Dashi-PD

Kozma Dashi është i diplomuar për inxhinieri. Ai ushtron aktivitet si pronari i biznesi të madh, por më shumë se për këto të dyja, ai njihet për shkak të një pasioni të vjetër: koleksionin e veprave të ndryshme të artit, fotografive, pjesëzave të historisë së vendit etj. Për sa i përket biznesit, Dashi është pronari i një kompanie që e ka shtrirë aktivitetin e saj tregtar në fushën e telekomunikacionit.

Majlinda Bufi-PS



Inxhinierja nga Rroskoveci ishte kandidatja nr. 8 në Qarkun e Fierit. Bufi ka mbaruar studimet fillimisht për inxhinieri ndërtimi, më pas studio edhe Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës. Studimet "master" i ka kryer për politika agrare. Është anetare e Partisë Socialiste që prej vitit 1995 dhe anetare e Asamblesë së kësaj partie që nga viti 2011.



Robert Bitri-LSI



Fieraku 55-vjeçar ulet për herë të parë në Kuvend, ndërsa ka mbajtur disa detyra shtetërore gjatë viteve të para të socialisteve në pushtet. Robert Bitri, i diplomuar për agronomi në Universitetin e Kamzës ka qenë këshilltar i kryeministrave Bashkim Fino dhe Fatos Nano. Bitri është pronar i një kompanie ndërtimi. Që prej marsit 2012, Bitri ka mbajtur detyrën e prefektit të Qarkut të Fierit. Është i martuar edhe babai i dy fëmijëve.



Omer Mamo-PDIU

Biznesmeni 52-vjeçar siguroi mandatin e parë të Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet në Qarkun e Fierit, i cili ka një komunitet të gjerë çam. Me futjen e Mamos në Kuvend, PDIU siguroi mandatin e humbur për pak vota në zgjedhjet e vitit 2009. Mamo është një biznesmen i njohur në Fier, i cili e ka shtrirë aktivitetin e tij në fushën e ndërtimit dhe tregtimit të karburanteve.

Liljana Elmazi-PD



Profesoresha e Fakultetit të Ekonomisë është një ndër emrat e futur në listën e Partisë Demokratike, si përfaqësuese e Sarandës. Ajo ishte e renditur e treat. Ajo ishte deputetja e fundit e listës demokrate që dolën nga Vlora.



Ulsi Manja-PS



Dibranit iu desh ta provonte dy herë për të fituar një vend në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Në zgjedhjet e vitit 2009, kur PS nxorri vetëm dy deputet nga ky Qark ishte i renditur në listën jofituese. Ulsi Manja vjen nga radhët e drejtësisë. Ka qenë prokuror njëkohësisht edhe pedagog. Manja ka punuar për vite të tëra duke mbajtur poste të ndryshme në administratën publike.



Nga Alban Tartari



Revolucion social apo manipulim social?

Ndërsa shoh llogarinë time në *Twitter*, me vjen keq që s'mund t'i ndjek të gjithë miqtë e mi apo mediat që japin sekondë pas sekonde lajmet më të fundit nga çdo qoshkë e botës... Endem në *Facebook* dhe mendoj se do të më duheshin më shumë se 24 orë për të lexuar të gjitha postimet e këtyre 24 orëve të thuajse 4000 miqve (!) të mi...


Por unë sërish endem aty. Lexoj, mësoj, komunikoj, irrihem, gëzohem, flas ndoshta kur duhet të hesht dhe hesht ndoshta kur duhet të flas. Në këtë pikë, vija midis mbireagimit dhe indiferentizmit nuk ka qenë kurrë kaq e hollë. Dhe mendoni që unë jam vetëm një përdorues i këtyre rrjeteve, ndër miliona e miliona në faqe të dheut.

Por ja që këto rrjete nuk janë thjesht platforma, ku thjesht informohesh apo kalon kohën. Ato përveç ndërveprimit që sjellin në mënyrë direkte, po hyjnë në historinë e njerëzimit me ndikimin që kanë në mënyrë indirekte. Që do të thotë se është normale tashmë që të lësh një reagim të ashpër në llogarinë e kryeministrit në *Facebook* apo të liderit të opozitës në *Twitter* (apo mund të ishte e kundërta?). Në rastin më të keq një administrator i asaj llogarie do fshijë komentet e tua.

Ato që ne i quajmë edhe media sociale, ku publikohet dhe konsumohet gazetari, nuk janë thjesht media.

Ngjarjet e fundit në botën arabe, Turqi dhe së fundi prapë në Egjipt, treguan për fuqinë e mediave sociale. Duke mos dashur të analizojmë sërish atë që u quajt "pranvera arabe", po ndalemi në rastin e Turqisë, një rast shumë interesantë për nga dinamikat që paraqet.

Turqia është një republikë demokratike-parlamentare, pra nuk mund të quhet një regjim ashtu siç u përdor e emërtua edhe në median shqiptare. Këtu nis edhe suksesi i këtyre mediave sociale në Turqi. Në një mënyrë që dyshohet se ishte një lëvizje e organizuar, qindra e mijëra përdorues bënë thirrje për "rrëzimin e regjimit të Erdoganit". Kjo u lexua në këtë mënyrë nga rrjetet mediatike ndërkombëtare dhe natyrisht edhe nga mediat lokale. Mendohet se brenda një kohe të shkurtër, më se njëzet mijë adresa të reja u çelën në rrjetin *Twitter* dhe pak më shumë se dhjetë mijë në rrjetin



Facebook. Shumica e njerëzve kishin hapur adresa në këto rrjete me emra të njohur, por që ishin çelur nga të tjerë, me të vetmen arsye për të nxitur pjesëmarrje në protesta.


Mijëra vetë u derdhën rrugëve të Stambollit e sidomos në sheshin *Taksim*, pasi thirrjet në median sociale ishin: “dilni, po na vret policia...po mbytemi...po arrestojnë mijëra vete...” etj. Mediat sociale shkaktuan panik dhe reagim. Për pak kohë, ato praktikisht rrëzuan opozitën turke të drejtuar nga Partia Popullore Republikane (CHP) dhe e morën manaxhimin e situatës. Vetëm ditën e dytë të protestave të dhunshme, opozita reagoi.

Sigurisht policia e teproi me reagimin e saj ndaj turmave. Këtë e pranoi edhe vetë qeveria. Sigurisht që edhe protesuesit e tepruan. Risia e kësaj lëvizjeje është se rrjetet sociale u përdorën nga dikush, në mënyrë të orkestruar, kundër një qeverie të zgjedhur në mënyrë demokratike me thuajse më shumë se pesëdhjetë përqind të votës popullore.

Mediat tradicionale, TV, radiot, gazetat dhe revistat i qëndruan larg protestave në ditët e para. Kjo bëri që shumica e popullatës të mosinformohet për çfarë ndodhte në sheshin *Taksim*. Por nga ana tjetër, të rinjtë u ndikuan nga thirrjet e bëra në *Twitter* dhe *Facebook*. Me dhjetra foto të rreme u postuan në këto rrjete dhe shumica e turqve i besoi. Vetëm më pas rezultoi që një foto më mijëra vetë, me pamje në një prej urave të Stambollit nuk ishte e protestës, por e një maratone të mëhershme. Po kështu edhe fotomontazhe me dhunën e policisë...


Pra, rrjetet sociale u keqpërdorën. Dhe shumë vetë i besuan. Madje reagan duke dalë nëpër rrugë e sheshe, duke u përleshur me policinë apo duke dëmtuar pasuri publike dhe private. Kjo fushatë ndoshta ka ulur popullaritetin e kryeministrit Erdogan, por uli edhe imazhin e Turqisë dhe sidomos ndikoi negativisht në sektorin e turizmit. Vetëm nga Shqipëria kanë qenë me qindra raste të anulimit të vizitave turistike në Stamboll.

Në disa vende, si në ato arabe, media ka rrëzuar



diktatura. Por, në disa vende (siç është rasti i mësipërm), ajo është përdorur për të rrëzuar qeveri të zgjedhur në mënyrë demokratike. Hyrja në mënyrë tërësore në jetën socialo-politike e këtyre mediave a rrjeteve sociale ka dhe do të ketë një ndikim shumë të madh mbi mënyrën tonë të mendimit, reagimit komunikativ por edhe veprimit. Kështu që mendoj se studime më të thelluara duhet të bëhen lidhur me ndikimet sociale të këtyre rrjeteve në shoqërinë tonë.

A mund të përdoren ato në mënyrë jo etike për të luftuar ato sisteme dhe vlera të pranuar nga të gjithë? Ç'do të bëhet nëse çdokush mund të organizohet e të mblidhet përmes këtyre rrjeteve për lëvizje më të mëdha? Do jenë ato në vartësi të politikës, apo politika në vartësi të tyre? A janë mediat sociale një e drejtë informimi dhe shprehjeje? Apo janë një e drejtë dezinformimi dhe anarkie? Ka ardhur koha jo thjesht t'i përdorim këto rrjete sociale, por edhe të mendojmë mbi to.





Nga Jola Llozhi



Studimi i geneve, shqiptarët ngjajnë më shumë me evropianët

Një ndër kuriozitetet më të mëdha që kanë popujt për veten e tyre lidhet me prejardhjen. Kalimi i mijëra viteve, lëvizjet e popullsisë për shkaqe nga më të ndryshmet ka ndikuar që popujt të përzihen midis tyre duke bërë që në hapësira të ngushta gjeografike të jetojnë individë me prejardhje, kultura dhe zakone të ndryshme. Pavarësisht ndryshimeve

të hershëm apo ku jetonin ata. Duke u kthyer pas në kohë, dallojmë se të gjithë kemi ngjashmëri me paraardhësit tanë të 3 000-4 000 viteve më parë. Çfarë ndodhi midis kohës së atëhershme dhe kësaj të tanishme? Në Evropë, për shembull, migrimet e kohëve të fundit kanë ndihmuar në formësimin e boshllëqeve në mesin e popullsisë të sotme. Në këtë studim kemi një vështrim nga afër të rrënjëve të fundit të evropianëve moderne.



“Shqiptarët kanë të paktën 90 paraardhës të përbashkët me popullsitë e tjera evropianet gjatë 500 viteve të fundit. Kjo është shifër tepër e lartë krahasuar me popujt latin”

të mëdha, gjithmonë gjendet një pikëtakim për sa i përket geneve.

Në një fushë të ngjashme, kanë studiuar edhe profesorët amerikan Graham Coop dhe Peter Ralph. Ata kanë marrë kampione ADN-je nga rreth 40 shtete për të verifikuar ngjashmëritë gjenetike që kanë popujt me njëri-tjetrin. Nga studimi del se shqiptarët e Shqipërisë dhe e Kosovës, hungarezët dhe polakët kanë më shumë ngjashmëri me njëri-tjetrin (brenda etnisë) krahasuar me popujt e tjerë të Evropës.

Më poshtë kemi sjellë një përmbledhje të studimit të botuar në revistën shkencore “PLOS Biology”

Shumica prej nesh njohin vetëm disa breza të familjes, por përtej kësaj, nuk e dimë se kush janë paraardhësit tanë

Kërkimet e mëparshme tregojnë se gjenotipet në Evropë ndryshojnë me gjerësi dhe gjatësi dhe se diversiteti gjenetik ka tendencë të rritet nga veriu në jug. Për të marrë një pamje të qartë të bashkëveprimit mes lidhjes



së kohëve të fundit dhe gjeografisë në Evropë, Ralph dhe Coop krahasuan gjerësinë gjenomike të dhëna nga 2 257 njerëz në të gjithë kontinentin. Kërkuesit përdorën përafërsitë e segmenteve të gjata gjenome, si një kriter i prejardhjes së përbashkët midis njerëzve individualë, por dhe midis popujve. Pjesët segmentale bëhen progresivisht më të shkurtra gjatë kthimit prapa në histori, pasi ato kanë kaluar shumë breza të rikombinimit. Kështu, sa më i gjatë të jetë segmenti i përbashkët i genit, aq më shumë ka paraardhës të përbashkët të kohëve të fundit.

Ashtu siç pritet, krahasimi i këtyre segmenteve të gjata në varësi të shtetit rezultoi se afërsia është më e madhe midis njerëzve që jetojnë afër njëri-tjetrit. Paraardhësit e fundit në Angli kanë më shumë përafërsi me njerëzit në Irlandë se sa me vetë anglezët. Gjithashtu, njerëz në Gjermani, afërsitë me paraardhësit e fundit i kanë më shumë me polakët, sesa me gjermanët e tjerë. Ky model mund të reflektojë migrimet e popullsisë më të vogla drejt atyre më të mëdha.

Në mënyrë të ngjashme, ndërsa lidhja e kohëve të fundit bie në mënyrë të barabartë në të gjithë distancat gjeografike në Evropë, në përgjithësi ekzistojnë disa përjashtime. Pavarësisht nga afërsia fizike, lidhja e ngjashmërisë është e ulët midis gadishullit Apenin dhe pjesës tjetër të kontinentit. Në anën tjetër, kjo ngjashmëri është e lartë brenda Evropës Veriore si edhe në të gjithë Evropën Lindore, tre herë më shumë se brenda rajoneve të tjera në distanca të ngjashme.

Ralph dhe Coop përdorën edhe segmente të tjera të përbashkëta për të matur se sa të zakonshëm janë paraardhësit e kohëve të fundit për njerëzit në të gjithë Evropën moderne, si dhe afërsisht sa kohë më parë jetuan ata. Një person nuk e trashëgon materialin gjenetik nga çdo paraardhës. Kjo analizë zbulon vetëm një pjesë të vogël të marrëdhënieve të përbashkëta gjenealogjike. Studiuesit e quajnë këtë fraksion “paraardhësit gjenetik të përbashkët.”

Shpërndarjet e segmenteve të gjata treguan se paraardhësit gjenetikë duke nisur nga 500 vjet më parë, janë ndarë në mënyrë tipike vetëm nga njerëzit që jetojnë në të njëjtin vend sot. Folësit shqiptarë renditen të parët, me rreth 90 paraardhës gjenetikë të përbashkët, brenda 500 viteve të fundit. Nga ana tjetër, rreth çdo dy njerëz nga pothuajse kudo nëpër Europë, sot ndajnë qindra paraardhësve gjenetike nga më shumë se 1 500 vjet më parë. Sipas studimit, më pak të ngjashëm me evropianët e tjerë janë italianët dhe iberikët, të cilët kanë vetëm dy paraardhës gjenetikë të përbashkët me popullsi të tjera të kontinentit gjatë 1 500 viteve të fundit.

Ralph dhe Coop morën parasysh se këta paraardhës të përbashkët gjenetike janë vetëm një pjesë e vogël e

“Italianët dhe spanjollët janë më pak të lidhur gjenetikisht me popullsitë e tjera të Evropës”

Irlandezët kanë më shumë ngjashmëri me popullsitë që jetojnë në Evropën Lindore se sa me anglezët.

paraardhësve gjenealogjike. Bazuar në këtë, studiuesit arritën në përfundimin se madje edhe njerëz që sot jetojnë në skajet e kundërta të Evropës, ka të ngjarë që të kenë një prejardhje të përbashkët që përfshin të gjithë ata që jetuan një mijë vjet më parë dhe patën pasardhës. Konkluzioni se të gjithë evropianët janë të lidhur gjatë një periudhë kaq të shkurtër kohore jep shenja pozitive për teorinë që të gjithë në botë janë lidhur vetëm gjatë mijëvjeçarëve të fundit. Në të vërtetë, shkencëtarët spekulojnë se paraardhësit e përbashkët të Evropës gjatë mijëvjeçarit të fundit mund të jenë ndarë në mbarë botën.

Një tjetër gjetje intriguese është se numrat dhe koha e paraardhësve të zakonshëm midis pjesëve të ndryshme të Europës mund të pasqyrojnë ngjarjet më të mëdha në historinë e kontinentit. Numri i paraardhësve të përbashkët në 1 000 deri 2 000 vitet e fundit është veçanërisht i lartë në Evropën Lindore, i ngjashëm me ato në Irlandë, pavarësisht distancës shumë të madhe. Periudha përshtatet me serinë e migrimëve që filloi me hantët në shekullin e 4 dhe përfundoi me sllavët mes shekujve 6 dhe 10.

Në mbështetje të këtij kulmi lidhjeje me origjinë të përbashkët të këtyre migrimëve, shumë prej evropianëve lindore të sotëm të cilët ndajnë segmente të gjata, gjithashtu, flasin gjuhë sllave. Për më tepër, rajonet me paraardhësit më pak të përbashkët (Franca, Italia dhe Gadishulli Iberik) mendohet të kenë qenë më pak të prekur nga shpërnguljet e hanëve dhe sllavëve.

Ky studim vërteton dhe zgjeron të kuptuarit tonë në lidhje me të kaluarën e afërt të Evropës, duke shtuar një dimension tjetër në lidhje me atë që disiplinat e tjera na tregojnë rreth ngjarjeve historike. Përveç se duke na dhënë një pamje të plotë të lidhjeve të ngushta në mes të njerëzve në mbarë botën, gjithashtu, mund të ndihmojë për t'u dhënë përgjigje pyetjes më themelore të njeriut: Si dhe nga ku kemi kemi ardhur këtu ?

Nga Erlis Çela



Po media i arriti standardet?!

Pas përfundimit të një pale zgjedhjeje është e udhës që të bëhen analiza dhe komente pafund: pse humbi njëra palë, apo pse fitoi pala tjetër? Cili ishte roli i këtij lideri apo atij politikani? etj. Është dukuri e natyrshme që pas një procesi të rëndësishëm të analizohen shkaqet dhe deri diku të nxirren edhe përgjegjësitë. Një situatë të ngjashme po përjetojmë edhe këto ditë post – 23 qershor. Me një të hedhur të syrit mund të vësh re me dhjetra shkrime, opinione, komente dhe analiza që lidhen me zgjedhjet e fundit parlamentare. Analistë, gazetarë, politologë dhe “të papunë” rreken të analizojnë shkaqet e asaj që prodhoi 23 qershori. Shpesh, nëpër ekranet e mediave të ndryshme, nëpër faqet e gazetave, nëpër faqe informative në internet apo rrjete sociale shohim emra të cilët përpiqen t’i mbushin mendjen audiencës se në fakt ata vetë e kishin parashikuar

që do të ndodhte kështu apo ashtu.

E megjithatë në gjithë këtë inflacion fjalësh, ajo që mungon është pikërisht një analizë në lidhje me vetë median, të cilën rëndom e cilësojnë si pushteti i katërt. A e kaloi media shqiptare klasën në këto zgjedhje? A i arritëm standardet edhe në këtë fushë? Çfarë informacioni i përcolli publikut dhe sa e paanshme ishte në këtë mision? Nëse të gjithë baballarët e gazetarisë shqiptare do t’u kushtonin vëmendje këtyre pikëpyetjeve, nuk do t’u dilte koha të merreshin me partitë politike dhe performancën e tyre në këtë përballje elektorale. Nëse këtë performancë të medias shqiptare do ta vlerësonim ashtu siç bëjnë ndërkombëtarët me proceset elektorale në Shqipëri, kur fjalia e parë nis me “pati progres të dukshëm” dhe vazhdon me “por”, mendoj se pas fjalës “por” do të vazhdonin fjali pafund që jo vetëm nuk do të nxirrnin në pah problematikën e shfaqur, por do të lodhnin më kot lexuesin.

Ndoshta si rrjedhojë e polarizimit të gjithë shoqërisë, polarizimi i tregut mediatik në Shqipëri u vu re edhe gjatë kësaj fushate. Palët në garë vazhduan të shfaqin hapur preferencat e tyre për njërin kanal televiziv dhe mospëlqimet për kanalin tjetër. Politikanët kryesorë u shfaqën sërish selektiv në përzgjedhjen e ekranit apo gazetës nëpërmjet të cilës kërkuan të përcillnin mesazhin elektoratit. Nga ana tjetër dolën edhe njëherë në pah probleme të mëdha të medias shqiptare, si pasojë e lidhjeve të pronarëve të saj me politikën që shpeshherë janë jo transparente. Si pasojë e kësaj marrëdhënie që është



aq e komplikuar sa do të donte një analizë më vete, media shqiptare vazhdoi të mos kryejë detyrën e saj me profesionalizëm duke favorizuar njërën palë apo duke sulmuar palën tjetër, ndonëse për këtë çështje ka edhe detyrime ligjore që duhen zbatuar.

Ndërkohë që problemi i kthimit të ekraneve televizive në dritare “PR-i” për partitë politike nuk u shmang edhe kësaj here. Në zgjedhjet e kaluara u debatua për herë të parë publikimi ose jo i materialeve të montuara nga selitë e partive politike.

Në këtë fushatë pati një avancim vetëm në aspektin teknologjik, por jo më tepër. Nga kaseta të montuara kaluam nën transmetime direkte nga regji të ngritura anë selive të partive. Pra, planet që serviroshin nga mitingjet dhe takimet “madhështore” me qytarët ishin më parë të kuruara nga kjo regji qëndrore, çka solli sërish një deformim të rëndësishëm në informimin e publikut. Në këtë pikë ndihmoi edhe vendimi i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, i cili në mënyrë paradoksale mori vendim, i cili detyronte mediat të transmetonin materialet e montuara nga subjektet politike.

Ndërkohë që një nga zhvillimet më negative përse i përket medias në këtë fushatë dhe që mendoj se kërkon një vëmendje të veçantë është ndërtimi i një marrëdhënie kancerogjene të medias tradicionale me mediat e gjeneratës së re apo rrjetet sociale. Them kancerogjene pasi media tradicionale (televizioni, radio dhe shtypi i shkruar) duket sikur po pret degën ku kanë hipur vetë. Çdo person që futet te kategoria e publikut të vëmendshëm mund të vinte re me lehtësi se si thuaj se shumica e kronikave televizive fillonin duke cituar statuset e politikanëve kryesorë në facebook apo twitter.

Thëniet e Edi Ramës dhe e Sali Berishës në median sociale u shndërruan në burimin kryesorë të gazetarëve. Nuk kishte më nevojë as për të qëndruar pranë selive të partive politike, pranë kryeministrisë, kuvendit apo për të mbajtur lidhje me burimet e tua si gazetar, sepse çdo gjë vinte nga rrjetet sociale. Shefat e redaksive nuk i porosisnin më gazetarët e terrenit të kenë kujdes për të kërkur dhe zbuluar lajmin, por vetëm të mbajnë hapur 24 orë Facebook-un dhe Twitter-in, t’u bëjnë “like” të gjithë



politikanëve ku janë e ku s’janë dhe kaq mjaftonte. Madje, ajo që është akoma më e çuditshme, këto postime janë kthyer në burim edhe për shtypin e shkruar duke i shtuar akoma më shumë arsye pse s’ka më nevojë të blesh një gazetë. E çfarë të duhet një gazetë që del ditën e dytë dhe si titull të parë ka një nga statuset e ‘x’ politikani. Në këtë mënyrë, media shqiptare praktikisht i drejtohet vetëm atyre që nuk kanë llogari në rrjetet sociale apo nuk dijnë të përdorin kompjuterin.

Kategoria tjetër nuk ka asnjë arsye pse duhet të ndjekë një kronikë televizive apo një shkrim në gazetë. Kështu i shërbyem tkurrjes akoma më të madhe që po i ndodh audiences së mediave tradicionale. Një fenomen ky që nuk ka nevojë për ndihmën e televizioneve apo gazetave, sepse është një trend ndërkombëtar që po vjen natyrshëm për shkak të zhvillimeve teknologjike. Në një situatë të tillë është e udhës që së pari njerëzit e medias të merren pak me “oborrin e tyre” që vazhdimisht po gërryhet jo vetëm nga erozioni teknologjik, por edhe nga mungesa e përgjegjshmërisë të vetë drejtuesve dhe pronarë të vetë medias.

Sigurisht që të gjitha këto që përmendëm nuk vijnë për faj të gazetarëve apo kameramanëve, të cilët janë vija e parë e betejës. Ata janë të parët që thithin pluhurin që lënë pas makinat e pushtetarëve në kohë fushate, të parët që bien viktimë e presionit të pronarëve dhe të parët që paguajnë faturën e këtij tregu të deformuar. Ata sërish u përpoqën të bëjnë punën e tyre, sërish tentuan të sillnin formacionin më objektiv, u lodhën sërish dhe u paguan sërish më pak se sa e meritojnë.

Nga Rudi Dunga



Rotacioni politik në Shqipëri dhe ridimensionimi i marrëdhënieve me Kosovën

Fitorja e koalicionit të majtë në zgjedhjet parlamentare pritet të sjellë dhe një ridimensionim të marrëdhënieve të Shqipërisë me Kosovën. Para kryeministrit të ardhshëm të Shqipërisë, z. Edi Rama, shtrohet sfida e realizimit të premtimeve që shpalosi përgjatë fushatës elektorale. Një vend të rëndësishëm zë partneriteti strategjik me Kosovën. Në platformën e Partisë Socialiste, Kosova konsiderohet si partnere dhe aleate strategjike kryesore e Shqipërisë. Deri në këtë pikë, asgjë nuk ndryshon nga programi i ndjekur në tetë vitet e fundit nga qeveria e drejtuar nga ish-kryeministri, z. Sali Berisha.

Shqipëria, veçanërisht qeveria e drejtuar nga z. Berisha, dha një mbështetje të rëndësishme politike dhe morale në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe në njohjen e saj nga vendet anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ndërtimi i autostradës Durrës-Kukës, që vazhdon më tej nga Vërmica në Merdar ka ndikuar në lëvizjen e lirshme të shqiptarëve të Shqipërisë në Kosovë dhe anasjelltas. Dukshëm kemi një rritje të numrit të qytetarëve kosovarë që vizitojnë Shqipërinë. Këto vizita nuk ndodhin vetëm gjatë muajve të verës. E anasjelltas ndodh edhe me qytetarët shqiptarë që

vizitojnë Kosovën. Këto vizita të ndërsjellta e kanë rritur tepër afrimin e shqiptarëve me njëri-tjetrin, e kanë bërë më të prekshëm bashkimin de facto të tyre, duke “shembur” kufirin që i mbajti të ndarë për thuajse një shekull.

Ndërtimi i “Rrugës së Kombit” mund të konsiderohet si sukcesi më i madh i Berishës në tetë vite pushtet. Kjo ndikoi edhe pozitivisht në përforcimin e imazhit të tij ndër ta. Veç ndërtimit të rrugës dhe lobimit për njohjen e shtetit të ri, iniciativat e tjera të ndërmarra nga qeveria e



Berishës më tepër mbeten premtime teorike, sesa realizime konkrete. Si për shembull, sa i përket shkëmbimeve tregtare, në momente të caktuara kemi pasur bllokime të dyanshme të produkteve dhe mallrave të ndryshme që vinin nga vendet respektive. Në këtë drejtim, qeveria e të djathtëve nuk është shquar për ndonjë politikë favorizuese, kjo edhe për shkak të interesave të grupeve të caktuara me ndikim te pushteti. Sa i përket nismave në fushën e arsimit, e kulturës, e sportit, e energjetikës, etj. ato u përdorën më tepër si show politik nga kryeministri në largim. E tillë ishte edhe krijimi i një lige të përbashkët futbollit që u përfol gjatë, megjithëse





dihej se ishte diçka e paralizueshme, pasi binte ndesh me rregulloret e UEFA-s dhe FIFA-s.

Megjithatë, Sali Berisha është ende lideri i parapëlqyer nga shqiptarët e Kosovës. Më tepër se për atë që ka bërë, ndërtimi i këtij imazhi mund të lidhet me dy arsye: e para, ai është lideri i të djalhtës shqiptare dhe e dyta, thjesht si figurë kryesore politike në Shqipëri. Shqiptarët përtej kufirit kanë pasur perceptim pozitiv edhe për liderët e mëparshëm politikë të Shqipërisë, sepse ata ishin udhëheqës të shtetit mëmë, nga ku shihej shpresa.

Sfidat për kryeministrin e ardhshëm, z. Edi Rama janë kurimi i imazhit negativ që kanë shqiptarët e Kosovës për të dhe ridimensionimin e marrëdhënieve të shumanshme mes dy vendeve. Para elektoratit shqiptar, partia e z.

Rama paraqiti një program shpresëdhënës në këtë drejtim dhe basti, siç e quan ai vetë, mbetet kthimi i premtimeve në vepra konkrete.

Nëpërmjet nënshkrimit të Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së Mirë dhe Sigurisë, programi i Partisë Socialiste synon organizimin e mbledhjeve të përbashkëta të qeverive të dy vendeve, ku do të orientohen dhe mbikëqyren strategjitë e bashkëpunimit të thelluar në planin politik, ekonomik dhe social. Kësaj do t'i vinte në ndihmë edhe organizimi i një komiteti ndërshtetëror, Shqipëri-Kosovë, për të përafruar legjislacionin në dy kahe: përafrimin e legjislacionit tregtar dhe të legjislacionit në përgjithësi me Bashkimin Evropian.

E gatshme për realizimin e nismave të përbashkëta

është shprehur edhe qeveria e Kosovës drejtuar nga kryeministri Hashim Thaçi, i cili ka një qasje më të natyrshme me të majtën shqiptare. Një ide e hedhur më parë nga aleati i tij në qeverisje, z. Bengjet Pacolli, e përfshirë edhe në programin e PS-së, është organizimi i takimeve të përbashkëta në nivel qeveritar. Në këto takime parashikohet të diskutohet dhe vendoset për sigurinë energjetike të hapësirës shqiptare në këto dy shtete, sistemin e unifikuar arsimor, bujqësinë dhe zhvillimin rural, turizmin dhe njehsimin e ofertës turistike.

Për zhvillimin afatmesëm dhe afatgjatë, qeveria e re duhet të shohë me prioritet bashkëpunimin në fushën e arsimit, duke nisur fillimisht me unifikimin e kurrikulave të arsimit parauniversitar. Veç njehsimit të programeve të historisë, të gjeografisë, të gjuhës shqipe dhe të leximit letrar, siguri i cilësisë në arsim sigurohet nëpërmjet binjakëzimit të shkollave. Në interes të zhvillimit të arsimit duhet të stimulohen marrëveshjet për shkëmbimin e studentëve në programet e përbashkëta mes universiteteve (publike ose jopublike) të Kosovës dhe Shqipërisë. Këto tashmë janë praktika të njohura nga vendet evropiane.



Partia Socialiste e ka vendosur si një nga prioritetet kryesore të programit të saj zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural. Krijimi i një oferte të përbashkët në tregjet e eksportit me Kosovën do t'i jepte një hov zhvillimit rural, që gjatë kësaj kohe është lënë pas dore. Vitet e fundit është zhvilluar turizmi. Shqiptarët e Kosovës kalojnë verën në brigjet e Shqipërisë, por si edhe për ta, mungon turizmi gjithëvjetor dhe ai mbarëkombëtar. Në këtë pikë, programi i partisë që do të vijë në pushtet parashikon krijimin e një oferte turistike mbarëkombëtare, duke përfshirë në një rrjet të gjitha burimet turistike të hapësirave shqiptare.

Kreu i koalicionit të majtë, z. Edi Rama, në ligjëratën falënderuese ndaj popullit, tha: "Koha e fjalëve përfundoi!" Për të fituar "bastin" e dhënë për të ridimensionuar marrëdhëniet e shumanshme me Kosovën, atij dhe qeverisë së ardhshme i duhet një punë dhe angazhim serioz për të realizuar programin lidhur me partneritetin strategjik me Republikën e Kosovës.



Nga Luis Bekteshi



Mania Facebook



Facebook-u është një nga rrjetet sociale më të përdorura dhe më popullore në botë. Statistikat e fundit tregojnë se ky rrjet ka më shumë se një miliardë anëtarë. Facebook-u është shndërruar në një nga rrjetet sociale më të përdorura për arsye të shumta.

Në *Facebook* përdoruesit kanë mundësi të krijojnë profile të tyre online, mund të bëhen anëtarë të grupeve që lidhen me interesa specifike, të bëhen ndjekës të personazheve që vijnë nga fusha të ndryshme, të caktojnë axhendën, të luajnë, të informohen etj. Shumica e përdoruesve janë aktivë në këtë rrjet social, sepse ekziston nevoja për të pasur kontakte me të njohurit, si edhe për të krijuar njohje të reja.

Në këtë artikull ne do të analizojmë disa nga problemet dhe abuzimet që janë shfaqur me përdorimin e *Facebook*-ut.

Rreziku për të dhënat personale

Siguria e të dhënave personale është një ndër problemet që *Facebook* ka pasur me përdoruesit e tij. Janë të paktë njerëzit, të cilët i lexojnë me vëmendje pranimin e kushteve të vendosura nga *Facebook*-u. Kjo vjen si pasojë e neglizhencës së individëve. Ata nuk e kuptojnë që në momentin e klikimit të opsionit për pranimin e kushteve, është njësoj sikur ne të kemi firmosur një kontratë pa e lexuar fare se çfarë ka në të. Nuk janë të pakta kritikrat e bëra ndaj *Facebook*-ut për ekspozimin dhe madje shitjen e të dhënave të



përdoruesve. Është mëse normale që rrjetet sociale të kenë probleme për ruajtjen e të dhënave, por shitja e të dhënave të përdoruesve është e ndaluar, pasi këto mund të kopjohen nga piratët. Vetë Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Barak Obama, ka deklaruar se ai nuk i lejon fëmijët e tij të përdorin rrjetin social *Facebook*, për shkak se privatësia e tyre nuk është e garantuar. Pra, nga çfarë kuptojmë, të dhënat e gjithkujt që regjistrohet në *Facebook* janë të ekspozuara ndaj kompanive ose

individëve të interesuar për të abuzuar me to.

Në të shumtën e rasteve, kompanitë e reklamave janë palët më të interesuara për blerjen e të dhënave të përdoruesve, pasi i jep mundësinë të kontaktojnë klientë të mundshëm nga vende të ndryshme dhe me një kosto shumë të ulët. Problemi më i madh janë piratët e kompjuterave, të cilët vjedhin të dhënat e përdoruesve dhe i përdorin ato për qëllime të ndryshme. Kjo është një nga arsytet se pse rrjetet sociale janë pre e sulmeve të vazhdueshme të piratëve.

Facebook mund të shkatërrojë karrierën



Popullariteti i rrjetit social *Facebook* sa po vjen e po rritet. Shumë përdorues të këtij rrjeti nuk janë plotësisht të ndërgjegjshëm për rrezikun e të ardhmes së tyre si pasojë e përdorimit të tij. Shumë personave u është shkatërruar karriera si pasojë e postimeve në profilin e tyre në *Facebook*. Raste të tilla janë më të shpeshta nga ç'mendohet zakonisht. Në artikullin e Kristen Valles, botuar në "Charlotte Observer" me titullin: "Shefat kontrollojnë punonjësit nëpërmjet *Facebook*-ut" gjenden raste të ndryshme të punonjësve të pushuar nga puna për shkak të veprimtarisë së tyre në këtë rrjet. Kjo vjen për shkak se biznese të ndryshme janë të interesuar të mbajnë një lloj imazhi në sytë e publikut. Ndonëse ajo që punonjësit mund të bëjnë gjatë kohës së tyre të lirë nuk është kundër ligjit, mund të çënojnë imazhin e bizneseve ose kompanive. Fotot më shqetësuese janë ato që përfshijnë përdorimin e alkoolit, fotot me veshje të papërshtatshme ose përdorimi i termave raciste e diskriminuese. Në vitin 2005 një punonjës i "Google Inc." u pushua nga puna për faktin se ai u ankua në blogun e tij personal për kompaninë.

Ky nuk është shembulli i vetëm. Një stjuardese e "Delta Air Lines" deklaroi se ajo u pushua nga puna për shkak se kompania pa disa foto të papërshtatshme në profilin e saj të *Facebook*-ut. Biznese të ndryshme i kanë kërkuar punonjësve të tyre, ose edhe aplikantëve, që të shkruajnë në CV-në e tyre në qoftë se janë përdorues të rrjetëve sociale. Pra, vetë bizneset janë të shqetësuara për imazhin e tyre dhe se si punonjësit e tyre përdorin profilin e tyre në rrjetet sociale.

Në artikullin e shkruar nga Christopher Hope dhe të botuar nga e përditshmja britanike "The Telegraph" me titull: "Kujdes – *Facebook*-u mund të

dëmtojë të ardhmen tuaj," thuhet se rreth 5 milionë përdorues të rinj mund të kenë shkatërruar karrierën e tyre për shkak të të dhënave që postojnë në këtë rrjet social. Në një anketë të kryer me mbi 2000 të rinj britanikë nga mosha 14-21 vjeç, rezultatet treguan se 6 nga 10 prej tyre nuk kishin menduar se gjërat që postonin në *Facebook* mund të jenë të përhershme dhe mund të shikohen edhe në vitet në vazhdim. Shtatë prej dhjetë të rinjsh nuk ishin të shqetësuar që njerëz të huaj mund të shikonin profilin e tyre.



Përdorimi i rrjeteve sociale nga pedofilët

Fox News në faqen e saj online ka publikuar një artikull të titulluar: “Ekskluzive: “Pedofilët gjejnë një ‘shtëpi’ për të përdorur rrjetet sociale në Facebook”. Artikulli është shkruar nga Jana Winter, ku theksonte se një nga grupet më të mëdha të advokimit propedofilizmit, North American Man/Boy Love Association (NAMBLA), përdor rrjetin social Facebook për të kontaktuar anëtarët e tyre; për të gjetur dhe për të shpërndarë foto të fëmijëve; për të ushqyer sjelljen grabitqare të anëtarëve të saj; për të identifikuar objektivat e tyre. Hetimi është kryer pikërisht nga gazetarja në fjalë.

Facebook deklaroi se i monitoron këto lloj grupesh dhe nuk e lejon krijimin e tyre pasi përbën një rrezik për përdoruesit. Këta individë janë të rrezikshëm për përdoruesit minore të rrjetit social Facebook. Edhe pse prindërit mundohen t'i mbajnë nën kontroll, zhvillimi teknologjik i jep mundësinë fëmijëve nën moshën 13-vjeç që të kenë akses nga burime të ndryshme. Diçka e tillë është shumë shqetësuese dhe na tregon sa kujdes duhet të kemi në përdorimin e rrjeteve sociale dhe t'i kontrollojmë dhe kufizojmë faqet që fëmijët mund të kenë akses.



“Alienizimi” i shoqërisë për shkak të Facebook-ut

Karl Marksi e ka përdorur termin e alienizimit për të thënë se në kapitalizëm punëtorët janë të alienizuar nga njëri-tjetri, ndryshe nga ç'ishte më parë. Kur flasim sot për alienizim, më tepër i referohemi alienizimit të njerëzve midis njëri-tjetrit, jo vetëm në vendet e punës, por edhe në shoqëri. Kjo vjen edhe si pasojë e përdorimit me orar të tejzgjatur të rrjeteve sociale, një prej të cilëve është edhe Facebook. Komunikimi virtual është rritur shumë, në kah të kundërt me komunikimin e drejtpërdrejtë. Kjo vërehet sidomos tek të rinjtë e sotëm, të cilët janë grupmosha që kalojnë orë të tëra para kompjuterit, duke lundruar në rrjetet sociale. Për ta është më e lehtë të shprehen duke postuar statuse të ndryshme, ose duke folur nëpërmjet chat-it, sesa ballë për ballë. Kjo ka bërë që në një farë mënyre të rinjtë të kenë botën e tyre virtuale, larg botës reale. Shumë prindër janë të shqetësuar për faktin se fëmijët e tyre shpenzojnë orë të tëra para kompjuterëve duke komunikuar me shokët e tyre. Kjo vjen edhe si pasojë e revolucionit teknologjik, ku komunikimi virtual është shumë më i lehtë për t'u realizuar.



Raportimi i krimit nëpërmjet *Facebook*-ut

Një ndër risitë e *Facebook*-ut për momentin është përdorimi i tij për të raportuar krimet. Kjo nismë u ndërmor në Skoci, ku përdoruesit e rrjetit social *Facebook* mund të raportojnë krime të ndryshme, duke mbetur anonimë ose jo. Në një artikull në faqen e BBC-së, me titull: “Raportimi i krimeve në polici nëpërmjet *Facebook*-ut” thuhet se me anë të iniciativës “Made From Crime” do t’i lejojë qytetarët që të paraqesin shqetësimet e tyre online, edhe në mënyrë anonime në qoftë se duan. Kjo vjen si pasojë e rritjes së përdoruesve të rrjetit social *Facebook*.

Një risi e tillë ka edhe anët e saj negative. Duke pasur parasysh që njerëzit shpenzojnë shumë orë në

rrjetin social *Facebook*, atëherë edhe raportimi i krimit ose i shqetësimeve të qytetarëve në *Facebook* do të ishte shumë i vështirë për t’u monitoruar dhe për t’u zgjidhur në të njëjtën kohë. Gazeta “The Telegraph”, në artikullin e saj me titull: “Forcat e policisë i kërkojnë qytetarëve të mos raportojnë krimet në *Facebook*”. Në faqen zyrtare të policisë së Norhamptonshire, qytetarëve u thuhet që t’i raportojnë krimet në mënyrën tradicionale, nëpërmjet telefonit. Kjo deklaratë erdhi si pasojë e postimeve të shumta, të cilat ishin të vështira për t’u kontrolluar, si edhe për absurditetin e disa prej këtyre postimeve.



Krimi në rrjetet sociale

Përdorimi i lartë i rrjeteve sociale ka bërë që shumë persona të bien viktima të krimeve të ndryshme. Në një artikull me titull: “Ekspertët paralajmërojnë që krimet në *Facebook* janë në rritje”, të botuar nga *Fox News*. Në të thuhet se krimet në *Facebook* janë në rritje dhe më të sofistikuara se më parë. Kjo ndodh për shkak se përdoruesit e rrjeteve sociale i besojnë të huajve më shumë se jopërdoruesve të rrjeteve sociale.

Në një artikull me titull: “Raportet për krimet që kanë të bëjnë me mediat sociale janë rritur me 780% në 4 vjet” të botuar nga “The Guardian” thuhet se oficerët e policisë deklarojnë se janë raportuar 4,908 krime që kanë të bëjnë me *Facebook* dhe *Twitter* krahasuar me 556 në 2008. Raportimet në polici për krime që kanë të bëjnë me përdorimin e *Facebook*-ut dhe *Twitter*-it janë rritur me 780% në katër vite, duke çuar në arrestimin e 650 persona, vetëm gjatë vitit 2011.

Llojet e krimeve variojnë në forma të ndryshme, siç janë ngacmimet seksuale, kërcënimet, vjedhja e të

dhënave, pedofilia dhe deri në gjetjen e viktimave nga përdhunues ose vrasës serial. Edhe pse disave mund t’u duket paksa absurde, në fakt është mëse e vërtetë. Një ngjarje e marrë nga artikulli me titull “Ashleigh Hall: ‘një gabim’ i kushtoi jetën adoleshentes”, të botuar nga “The Telegraph”. Në të paraqitet historia e një adoleshenteje. Ajo kontaktonte në *Facebook* me Peter Chapman, i cili i tha që ishte një adoleshent. Ashleigh i tha prindërve që do të shkonte tek një shoqe, kur në fakt ajo kishte lënë takim me përdhunuesin në seri, Peter Chapman. Në pak orë, adoleshentja u rrëmbye, u përdhunua dhe u vra nga Peter Chapman.

Siç mund të shikojmë rreziku që kanoset nga përdorimi i rrjeteve sociale është më i madh seç mund të mendojmë, prandaj njerëzit duhet të kenë shumë kujdes kur të shtojnë një person si shok në *Facebook*, pasi duhet të kemi parasysh që ne po e lejojmë atë të ketë akses në të dhënat tona personale dhe në jetën tonë.

UNIVERSITETI HËNA E PLOTË BEDËR NË SHIFRA

- Programe në nivel Bachelor.....7
- Programe Master:.....12
- Profile të ndryshme studimi master:....14
- Numri i Studenteve:.....479
- Studentë të huaj:.....25 %
- Shtetet nga vijnë studentët:.....15
- Stafit akademik efektiv :.....53
- Stafi akademik me kohë të pjeshme:....60
- Pedagogë me titull Prof. Dr.:.....10
- Pedagogë me titull Prof. Assoc. Dr:.....10
- Pedagogë me titull Dr:.....32
- Pedagogë në proces Doktorature:.....29
- Stafi adminstrativ:.....33

Bashkëpunimi ndërkombëtar

•Marrëveshje të firmosura
me universitete te huaja : **30**


•Studentë që përfitojnë nga
programet e shkëmbimit : **14**

Kërkimi shkencor

- Konferenca ndërkombëtare :.....7
- Konferenca kombëtare :.....3
- Konferenca studentor :.....2
- Seminare të organizuara:.....15
- Leksione të hapura :.....20
- Kumtesa shkencore të paraqitura:.. **250**
- Referuesit në konferenca :..... **300**
- Shtetet nga vijnë referuesit :..... **20**
- Publikime shkencore nga stafi :.....**66**
- Revista Shkencore :.....2
- Qendra Kërkimore :.....5

Biblioteka

- Libra në shqip : **4 000**
- Libra në gjuhë të huaj : **20 000**



HËNA E PLOTË BEDËR UNIVERSITY

Bachelor dhe Master në

Drejtësi
Komunikim
Shkenca Islame

Gjuhë dhe letërsi Turke
Gjuhë dhe letërsi Angleze
Psikologji Këshillimi dhe Petagogji

www.beder.edu.al



Nga Rahim Ombashi



KORÇA ME VILA ZOTËRINJSH

(E QESHUR DHE E PASUR)

Qendër e banuar herët, duke pasur si bërthamë kështjellën e Muzakajve, qyteti i Korçës nisi të zhvillohet me shpejtësi pas shkatërrimit të Voskopojës (1769-1779) dhe rënies politiko-ekonomike të Janinës (1822).

Herët ra në sy për rregullin e tij duke u vlerësuar “... **qendër simpatike, e qeshur dhe e pasur me vila zotërinjsh të ndërtuara prej guri që zbardhnin nga gëlqerja**” [8].

Sami Frashëri e përshkruan Tregun e qytetit me 757 dyqane e punishte të ndryshme, 23 hane, 34 furra, 2 banja publike, ndërsa brenda tij ndodheshin edhe 1 fabrikë pëlhure, 1 kullë e bukur sahati, 2 farmaci, 2 xhami, 1 medrese e 1 teqe, 4 kisha, 1 gjimnaz, 2 shkolla fillore shqipe si dhe shkolla të tjera për mësimin e greqishtes dhe të vllahishtes.

Në fillime rajoni ka qenë nahije e Manastirit, por më 1827 bëhet Kajmekamllëk (nënprefekturë), ndërsa më 1870 Mytesarifllëk (prefekturë), duke pasur në varësi nënprefekturat e Kosturit, Bilishtit e të Kolonjës. [7]

U shtuan llojet e zejeve të cilat nga rreth 60 që ishin në shekullin XVII, në këtë kohë në vend kishin arritur në rreth 80. Thimi Mitko vë në dukje se : *Çorapet dhe velenxat e Korçës janë më nam e shiten më të shumtat në Kostandinopojë.* [6]

Rëndësia që pati Korça, shkalla e lartë e zhvillimit që arriti, vlerat arkitektonike që përmban, tërheqën me kohë vëmendjen e studiuesve dhe udhëtarëve të ndryshëm.

Mesi i shek. XIX e gjeti një qytet në lulëzim e sipër, që tërhiqte gjithnjë e më tepër banorë të ardhur nga fshatrat përreth. Ritmet e shtimit mbas kësaj periudhe bëhen të përshpejtuara, gjersa më 1923 arriti të ketë 25. 598 banorë dhe të jetë qyteti më i madh i Shqipërisë.

Qyteti bëhet modeli shqiptar i përforsimit të tipareve kolektive. Ndërtimi i sahatit të qytetit në vitin 1784 u mundësua nga esnafët e bakenjve myslimanë dhe ortodoksë voskopojarë. Tradita u përforsua me ngritjen e ndërtesave qeveritare: Liceut Kombëtar (ish Liceu Francez), bibliotekës, ndërtimin e çezmave, spitalin për të varfërit etj.

Lidhjet me vendet fqinje dhe më gjerë, i shtojnë banorët të bëjnë kujdes për shkollimin. Dëshmia e parë për çeljen e



shkollës në qytet është e vitit 1724. Në vitin 1738 shtatë esnafët e Varoshit të Korçës morën vendimin për të hapur shkollë që të mësojnë djemtë pa pagesë “cilitdoqofshin” [4] Komuniteti i kthen përgjigje Naum Veqilharxhit për letrat botuar në “Ëvetarin” e tij, botimi i dytë: **“Shpëtuam nga aq vjet përbuzje e cila rridhte prej mungesës së mësimit?”** [9]

Kushtet e reja ekonomike ndikuan dhe në cilësinë e jetës. Pas disa çezmave, u shtruan rrugët me kalldrëm, u çelën barnatore dhe klinika mjekësore. Institucionet fetare kryenin detyrimet për ritin e lindjes, dasmës apo varrimit si dhe rritën kujdesin për varrezat. Shërbimi i pastrimit bie në sy të mikes së madhe të shqiptarëve, që e quan Korçën “... qytetin më të pastër të Turqisë evropiane i cili madje *dukej i qytetëruar*”. [1]

Me gjithë fuqizimin ekonomik, një masë e madhe fuqie punëtore, mori rrugën e kurbetit: Vllahi, Egjipt, pastaj Greqia, Turqia e Bullgaria, por edhe më larg, si në Rusi, Ukrainë, Poloni, në Rumani etj. Në fillim të shekullit XX emigracioni ndryshoi drejtim: vendin e parë e zunë ShBA. [10] Është me rëndësi historike të theksohet se mërgimtari i parë shqiptar në Sh. B. A ka qenë nga fshati Katund i zonës së Vakëfeve të Korçës (1884).



rrëfimin mbi njeriun privat, ndërkohë që krijuesi qytetar i kësaj treve ndjente nevojën të kishte raporte kritike ndaj traditës. Intensiteti në rritje i kohës historike e diktonte të ishte më i kursyer me të, ndaj bota e krijuar prej tij kërkonte tregimin që e kishte rrëfimin e rrudhur, apo novelën ku nga imtësitë e përditshme arrinte të merrte mbresa maksimale duke dhënë fatet e individëve që sa vinin e më fort veçonin nga masa. Banorët e kësaj treve ishin besimtarë të mirë, ndaj në krijimet e tyre, tashmë zot në vendin e vet, veçmas pas Shpalljes së Pavarësisë, mbështeten fort në Kodin Biblik dhe Kodin Islam. Semiotikani kanadez Northrop Fraj ka gjetur fakte bindëse se “Letërsia e Perëndimit ka qenë e ndikuar nga Bibla më shumë se nga çdo libër tjetër”.

Ndaj ka aq shumë përlulesi e dëshirë për të falur dashuri, jetë të krijimet në prozën e shkurtër, të mesme dhe të gjatë të kësaj periudhe. Kodi atdhetar që kishte mbizotëruar përkohësisht në periudhën e Rilindjes Kombëtare po ia linte natyrshëm vendin kodit për dhe me njeriun.

Me mendësinë e vendeve ku mërguan, banorët e Korçës i ndihën pluralizmit në Shqipëri dhe forcuan tolerancën fetare:

Në muajin shkurt të vitit 1921 do të bëheshin në Shqipëri të parat zgjedhje parlamentare. ... Pas përpjesëtimit të elementeve fetarë, Korça duhet të kishte katër deputetë të krishterë dhe jo pesë. Por pas një ligji mbi zgjedhjet, shumica fetare, po të deshte, mund ta humbiste në favor të pakicës. Dhe kjo u vu në veprim në Korçë ku më parë këta elemente ishin për gjysmë. [10]

Mërgimi i ndihu korçarët për të mbështetur ndërgjegjen kombëtare që po fuqizohej.

Të enjten e javës së madhe, 28.04.1921, mbasdite, në kishën e Shën Gjergjit u nis meshimi në shqip. ...

Çështja kishëtare u zgjidh përfundimisht më 12

Patriotët korçarë ishin ata që jepnin paratë në Bukuresht për të shtypur librat. Korçar ishtë Mandi (Dhiamandi) Tërpo që fali shtëpinë për të bërë shkollë. Dhe ishin patriotët korçarë që dërguan fëmijët në këtë shkollë, prandaj dhe apostulli i Rilindjes, Naim Frashëri, ja vuri Korçës atë kurorën e lavdisë: Lumja ti moj Korçë, o lule, / Ç’i le pas shoqet e tua, / Si trimi në ball’ u sule, / Ta paçim përjetë hua!

Kjo kurorë lavdie, që i vuri Naimi Korçës nuk do të vyshket kurrë! [5]

Pragshpallja e Pavarësisë do t’i gjente krijuesit e trevës së Korçës Plakë duke përplotësuar individualitetin dhe integritetin e tyre artistik. Zhvillimet e shpejta dhe cilësore të ekonomisë borgjeze në këtë pjesë të dalluar të atdheut po veçonin individin, i cili në fushë të krijimit artistik në prozë po i largohej opinionit publik duke synuar

Panorama e Korçës





shtator 1922 kur Kongresi Kishëtar që u mbledh në Berat shpalli Autoqefalinë e Kishës Ortodokse shqiptare. [10]

Pas këtij vendimi, e njëjta gjë u bë edhe me pavarësimin e besimit islam shqiptar.

Qëndrimi kritik, sa vinte e rritej, por edhe nevoja për një arsimim bashkëkohor të rinjve shqiptarë për të qenë të aftë të garonin mes tyre por dhe me fqinjët e tyre në rajon e më gjerë.

Liceu frëng që u çel në Korçë ishte vepra më me rëndësi që i bëri Zogu Shqipërisë. [10]

Një nga vajzat e autorit të shënimeve jep këtë detaj që flet shumë:

*Dhe ai në vend të shpjegimeve të tjera na tregonte një botim të vjetër frëngjisht që e ruante si sytë e ballit. Në të, më 7 prill 1917, gazetari **Robert Vaucher** i revistës "Illustration", shkruante: ... **Republika e Korçës është sot ndofta i vetmi shtet në Europë që ekuilibronte buxhetin e tij e nuk kishte deficite ...** [10]*

Qyteti zbukurohej me klube, kafe, salla luksoze, kinema, shtypshkronja, por edhe me ndërtesa të tjera administrative. U krijuan lulishte të vogla publike, ku u vendosën monumente, ndërsa në festa aty luante banda muzikore e qytetit.

Së bashku me Shkodrën, qyteti i Korçës qysh në prillin e vitit 1926 krijoi ndriçimin urban me centrale elektrikë. Jeta qytetare pasurohej nga jeta publike me xhirot e përditshme në bulevardin kryesor, organizimin e pikniqeve në rrethinat, ballot zyrtare të organizuara nga shoqëri të ndryshme, koncertet muzikore. Më 17 qershor u formua shoqëria artistike "Lyra" e cila kishte një kor të përbërë prej 35 vetësh, kurse orkestra arrinte deri në 15 vetë. *Aktiviteti i shoqërisë "Lyra" është i gjithanshëm. Ajo përveç koncerteve dhe "Muzikës së Dhomës", merr pjesë në korin e kishave, në festat e ndryshme fetare dhe popullore, në ballot dhe serenatat korçare dhe kudo mirëpritet nga publiku.* [3] Për elitën e shoqërisë të rajonit ishte e zakonshme verimi në fshatrat klimaterikë, apo edhe deri në Pogradec, Shën

Naum e Strugë, madje dhe udhëtimet në Greqi, Jugosllavi, Turqi apo më larg.

Ecuria pozitive vijoi pas mbarimit të krizës botërore 1929-1934.

Qyteti ziente nga një jetë e pasur fiskulturore dhe sportive. Individë apo ekipe të tij njiheshin edhe në aspektin ndërkombëtar.

Qyteti i fabrikës së birrës "Korça", birra e parë shqiptare, si një produkt simbol për gjithë rajonin, e famshme për cilësinë e saj edhe nga tri medaljet e arit të marra në panairin e Selanikut në vitet 1933, 1934 dhe 1936, u pasurua edhe me një punishte zdrukhtarie, një oficinë mekanike, tri punishte leshi, dy fabrika lëkurësh dhe një fabrikë gozhdësh. Më 1936-38 në Korçë u ngritën njësi të reja industriale si fabrika e këpucëve të kauçukut "STIK", një fabrikë trikotazhi, ajo e qirinjve, e nishestesë, e mëndafshit artificial, e litarëve dhe piperit.



Korça rrezatoi qytetari në gjithë vendin. Veshja qytetare në periudhën midis dy luftave botërore, asaj I dhe II, pasoi ndryshime të mëdha. U përhap vullshëm moda perëndimore: “Rrobot“alla frënga”në veshjen e burrave të krishterë e myslimanë, visheshin radhazi në Korçë, mbas 1912-ës duke filluar qysh nga 1880.”[2]

Korçarët dhe Korça janë një binom shprehës. E duan fort Korçën plakë dhe se është e tillë dhe se janë të tillë, edhe kur gjenden larg saj, sepse i josh bota e pakufi, e marrin me vete atë si kujtim. Jep një sinjal kitare dhe të gjithë zgjohen, jo pak me sy të përlotur malli e dashurie. Diçka kanë nga kalldrëmet që presin me mall. Nuk janë të paktë ata që kthehen dhe atëherë saora u kthehen detajeve të jetës, gjërave konkrete, flasin e mendojnë për hollësitë e përditshme, kur dhe si do të marrim më shumë kulturë, kur do të debatojmë, kur do t’i vëzhgojmë të gjitha e gjithçka. U pëlqen të jetojnë me dinjitet sipas parimit të filozofit romak Seksted Empirikus që të mëson ta shohësh jetën me gjak të ftohtë, me qetësi për çdo gjë që ngjet rreth nesh, në ataraksi.

BIBLIOGRAFI

1. Duerham, M. E. (1905). *The Burden of Balkans*.
2. Gjergji, A. (2002). *Mënyra e jetesës në shekujt XII – XX*.
3. Jorganxhi, Zh. (2005). *Gaqo Jorganxhi dhe grupi “Lira”*.
4. Kodiku, dok.71.
5. Kolevica, P. (1992). *Lasgushi më ka thënë...*
6. Mitko, Th. (1834). *Topografia e Korçës*, “Fiamuri i Arbërit”, Nr. 9.
Mitko, Th. (1923) *Veper. cit., f. 548; N.D.N., Veper cit.*
7. N. D. N., (1923). *Korça dhe katundet e qarkut*.
8. Pellegrini, B. (1906). *Verso la Guerra? Il dissidio fra l’Italia e l’Austria*.
9. Pepo, P. *Dy dokumente....* Pepo, P. (1972) *Materiale dokumentare për ambientin shoqëror të Varoshit të Korçës, “St. Historike/1”*. Pepo, P. (1966). *Një letër e korçarëve e vitit 1845 drejtuar N. Veqilharxhit në Rumani, “St. Filologjike/1”*
10. Zoi, N. (2001). *Një faqe historie*.



**Mos vrit veten
dhe të tjerët përreth!**





Nga Jola Llozhi dhe Altin Tufa

Atje ku gurët fluturojnë

Të udhëtosh midis gurëve është fati i përdoruesve të trenit, të cilët për shkak të nevojave ekonomike duhet t'i nënshtrohen. Modestë dhe të thjeshtë në paraqitje... duket sikur kërkesat e tyre nuk janë të një standardi të lartë. Nuk ankohen për kushtet e brendshme të trenit, as për shërbimin e ofruar. I vetmi problem për ta ngelen gurët që gjuajnë drejt xhamave të trenit adoleshentët pranë hekurudhës. I afrohem stacionit të trenit dhe fillojmë pyetjet tona drejt udhëtarëve të rastit. Abdyli, 39 vjeç, nga Tirana, na drejtohet duke thënë: "Kam frikë se nuk e realizoni dot reportazhin, nuk shkoni dot nga gurët!" Abdyli shprehet se zona afër "City Park" është një ndër zonat më të rrezikshme. Ai tregon se ka qenë i pranishëm në shumë raste, por gjuajtjeve me gurë nuk u përgjigjen dot as policët. Udhëtari tregon se polici gjendej në tren, por e vetmja nismë që ka mundur të ndër marrë është gjuajtja në ajër me pistoletë, rreth 2 kilometra pas largimit nga vendi i gjuajtësve.

Kastrioti është një udhëtar tjetër i prekur nga ky fenomen. Ai shprehet se ka përfunduar me një plagosje të lehtë. Pranë tij gjendet një zonjë më një çantë të zezë, shumë të vjetër dhe pjesa e rripave e arnuar me pe të

bardhë. Gjithashtu, këpucët janë të qepura me të njëjtin pe. Dëshpërimisht, të dy shtrojnë pyetjen se a do të vijë një ditë që edhe ne të jemi të qetë nga gurët?

Treni u nis, por duket sikur rregullat nuk gjejnë vend për zbatim. Fëmijët dalin në dritare dhe polici nuk i ndalon dot. Faturino diku pyet për biletat. Te zona ndërmjet vagonave sheh disa të rinj që ulen të bëjnë pompa, mundje, lojra improvizuese. Të moshuarit ankohen për zhurmën që të rinjtë me të qeshurat e tyre shkaktojnë. Një qytetar është i detyruar të qëndrojë në këmbë afër motorit të tij, te zona lidhëse e vagonave, pasi shprehet se mungon vagoni i mallrave. Më shumë ne u përpoqëm të shikojmë gjendjen e përgjithshme të trenave, sesa nevojat minimale të udhëtarëve, nevoja qesharake të cilat vendet e tjera të botës nuk i njohin. Pjesa rrethuese e zonës së trenit që ndan zonën e banueshme nga hekurudha nuk ekziston më, sepse pjesët janë shitur për skrap. Punonjësit e trenit tregojnë se ka pasur raste kur edhe vetë ata janë plagosur dhe dërguar në spital.

Një 12-vjeçar nga lagjia nr.3 në Kamëz, i gjendur me ne në tren tregon se edhe ai vetë ka gjuajtur me gur,



por tani duke qenë se është i vetëdijshëm për pasojat, pretendon se nuk gjuan më. Megjithatë, ai tregon se si shokët e tij, nga moshë 10 deri në 15 vjeç, vazhdojnë këtë akt jonormal. Gjuajnë ngaqë treni i bie borisë dhe bën zhurmë.

Periodha që ka më shumë fëmijë që gjuajnë është gjatë sezonit të verës, pas mbarimit të shkollës. Lagjia më e rrezikshme dhe më me probleme rezultojnë lagjia numër 3 në Kamëz. Banorët e kësaj zone janë popullsi kryesisht me prejardhje nga zonat rurale të veriut. Gjuajtja e trenit është kthyer për këta fëmijë në një lojë argëtuese, ku ata e kanë fare të thjeshtë të mendojnë prapësi nga më të ndryshmet për t'iu kundërpërgjigjur problemeve, që sipas tyre ua shkakton kalimi i trenit. Të penguarit e trenit prej fëmijëve tashmë përbën një normalitet.

Një marifet tjetër i një grup fëmijësh për ta penguar udhëtimin e trenit është edhe bllokimi i shinave me gurë të mëdhenj. Qëllimi i tyre është ndalimi i trenit, për ta goditur sa më shumë atë.

Një çmenduri tjetër po nga këta fëmijë është kalimi i shinave të trenit nga njëra anë në anën tjetër, që nga momenti kur e shohin trenin 100 metra larg. Atëherë fillojnë lojën duke vendosur edhe baste me çmim fillestar 50 lekë.

Kur e pyesim makinistin në lidhje me problemet e trenit, ai shprehet se ka mungesë në sinjalistikë: "Nëse edhe fëmija im del përpara, nuk mundem të ndaloj. Madje, shteti nuk më dënon për këtë, sepse kur ka vështirësi makina në ndalim, ç'mund të mendojmë për forcën e fërkimit midis dy hekurave?," E pra, fëmijët nuk e mendojnë se mund të humbasin edhe jetën, për shkak se treni ka vështirësi në ndalim.

Për këta fëmijë janë marrë edhe masa ndëshkuese. Ka raste kur policia i merr me vete në makinë dhe pasi i dërgon deri në një farë pike, i lë që të kthehen vetë në këmbë në shtëpi. Por, ka edhe raste kur fëmijët godasin me gurë duke thyer xhamat e dritareve të trenit

dhe diktohen nga personat nën vëzhgim, gjobiten me shumën e vlerës së objektit.

Një raport i hartuar nga një institut norvegjez tregon se Shqipëria është i vetmi shtet në Europë ku hekurudhat janë me një shpejtësi nën mesataren. Vendi ynë ka rreth 470 km transport hekurudhor, por ai përdoret shumë rrallë, sepse trenat janë të vjetër e gjendja e rrjetit hekurudhor është shkak i aksidenteve të shumta. Të paktën tre persona kanë qenë viktime që nga janari i vitit 2013, i aksidenteve të trenave në Shqipëri, ku masa e sigurisë dhe kontrollit është shumë e ulët sipas policisë. Shqipëria ka vetëm një linjë hekurudhore ndërkombëtare me Malin e Zi, por thjeshtë shërben për të transportuar mallra. Ekspertët e transportit shprehen se rrjeti hekurudhor shqiptar është mjaft i degraduar, asnjë investim nuk është bërë gjatë njëzet viteve të fundit.

"Rrjeti i hekurudhave në Shqipëri është në një gjendje të degraduar, investimet në këtë sektor kanë qenë të ulëta edhe pothuajse inekzistente për disa vite," thotë Ervin Minarolli, një zyrtar i lartë i transportit.

Petrit Baku, një mekanik i vjetër që ka më shumë se dyzet vite pune në këtë sektor shprehet se sistemi aktual hekurudhor në Shqipëri është në një gjendje mjerimi. "Këto janë trena të vjetër dhe çdo herë ne duhet të jemi të kujdesshëm për të shmangur të keqen"- thotë ai.

Në vendin tonë mund të kalohet shumë lehtë sipër shinave të trenit, për shkak se nuk ekziston asnjë masë mbrojtëse.

Më datë 23 Maj, burimet nga Ministria e Transportit njoftuan se në bashkëpunim me BERZH po hartohet një plan për mënyrën e ndërhyrjes dhe vënien në zbatim të planit me koncesion. Sipas raportit, numri i udhëtarëve krahasuar me vitin 1994 ka rënë me pothuajse 10-fish. Në bilancin ekonomik, Drejtoria e Hekurudhave raporton çdo vit humbje në vlerë 1 milion euro.





Nga Erida Sulika dhe Muzafere Dema

Të jetosh me frikën e vdekjes

Bulqiza është një vend i vogël në verilindje të Shqipërisë me një pasuri në dukje të pashtershme nëntoksore, po me një varfëri që shihet kudo. Nëse vendos të shkosh qoftë dhe një herë të vetme në Bulqizë, gjëja e parë që do të ndeshësh në hyrje të qytetit është një tabelë e madhe ku shkruhet: “BULQIZË,ACR,Albanian Crome”.

Qyteti është i mbushur me minatorë që nxitojnë: dikush për në punë e dikush tjetër për në shtëpi pranë familjes, për të treguar se ja, shpëtoi dhe njëherë nga “tunelet e errësirës”. Këto tunele kanë marrë jetën e qindra minatorëve, të cilët u futën një mëngjes dhe e patën të pamundur që të dilnin sërish në sipërfaqe e të drejtosheshin si çdo natë drejt shtëpive të tyre të thjeshta.

Bulqiza njihet nga të gjithë “qyteti i minatorëve”. Po a mund të quhet dhe të identifikohet minator një 16-vjeçarë apo 17-vjeçarë, që shfrytëzohet dhe mbyllet për 8 orë me rradhë në këto tunele errësire? Për shumë nga ju kjo mund të duket e pamundur, por ky është realiteti që ekziston në këtë qytet të vogël kromi.

17-vjeçari A.H, me një fytyrë ku duket qartë dhembja, lodhja dhe vuajtja, tregon për punën e tij në një kompani private: “Nuk di asgjë për punën në minierë, por kjo është e vetmja rrugë që unë të mbijetoj, jam i vetëm në këtë botë, prindërit më kanë lënë jetim që në moshën 4-vjeçare”. I përloitur tregon se malli dhe dëshira për t’i patur pranë është e madhe. Mbështetja e tyre është ajo që i ka munguar gjithmonë. E vetmja që e ka përkrahur në këtë jetë është gjyshja nga ana e babait. “I jap kurajë vetes që të vazhdojë përpara me shpresën se ditë më të mira do të vijnë për mua, lodhja që kam çdo ditë është e papërshtueshme, puna në këto tunele për mua është mëse e vështirë, por nuk kam zgjidhje tjetër pasi kjo është e vetmja mënyrë që unë të siguroj jetën” .

Tek largohesh nga ky i mitur, ku mes lotëve dhe dhimbjes lutesh që dhe ai si shumë të tjerë të bëjë një jetë të qetë dhe të sigurt, më tutje, takon një 30-vjeçar të ndrojtur. Ai ka frikë të shprehë vështirësitë dhe vuajtjet

që ka në punë. I lodhur, i rraskapitur me rroba modeste dhe me një fytyrë ku duket qartë dhimbja, i zhgënjyer nga mjedisi i punës, lutet çdo ditë me shpresën se ditë më të mira të vijnë për të. Ai mallkon ditën që është futur në këtë punë të zezë. Kur e pyet për kushtet, zëri i dridhet dhe pak nga pak nis dhe flet për pakënaqësitë dhe për punën e zezë ku ndodhet. Ai shprehet: “ Nuk ka asgjë që mund ta vlerësoj te kjo punë, firma nuk na siguron asgjë, të duket vetja sikur je në një hapësirë të pafundme e të pakuptimtë. Çdo gjë duhet ta përgatisim vetë. Mbi supe, duhet të mbajmë shina deri në 700 m largësi. Ato duhen për përgatitjen e rrugës nëpër të cilën na duhet të kalojmë vagonin me krom. Mungon ekzistenca e një spitali. Në rastin e incidenteve nuk ekziston ndihma e shpejtë, madje ka dhe raste kur këto incidente fshihen nga drejtuesit e këtyre minierave, pasi puna që bëjnë është e paligjshme dhe për të mbrojtur veten dëmtojnë shëndetin e shumë të pafajshmëve, të cilët punojnë me forcën e tyre për të siguruar mbijetesën”, theksoi në fjalët e tij 30-vjeçari F.T.

Të gjithë thonë “Miniera e Vdekjes”

Minatori H.A me përvojë pune prej 23-vitesh tregon pakënaqësitë për punën në minierë. 48-vjeçari, mes lotësh dhe dhimbjes tregon sfidat me të cilat është përballur gjatë punës së tij, vështirësitë që ai ka në këtë moshë për të





punuar dhe se në shumë raste ndihet i pafuqishëm, por është mbajtja e familjes që e detyron akoma të vazhdojë punën në këto tunele. Turni i natës është një vështirësi e dyfishtë. Ai tregon një rast ku i është dashur të ecë gati 2 km mes borës e acarit për të shkuar në punë, për të siguruar bukën e fëmijëve. "Siguria në këto tunele është në nivel të ulët. Për shkak të hapësirave të shumta në këto galeri, fobia dhe frika për jetën janë shumë të mëdha. Aty është krijuar një "qytet nëntokësor". Vetëm për të arritur në vendin e punës, mua dhe shokëve na duhet të bëjmë gati 3 km rrugë. Gjithashtu, shëndeti ynë është mjaft i rrezikuar. Nga një vizitë mjeksore që na është bërë pak kohë më pare, nga 24 puntorë që ishte grupi im i punës, 18 prej miqve të mi dolën me probleme shëndetsore, kryesisht ftohje", theksoi H.A.

Në pamundësi për të pasur një jetesë të mirë dhe shpeshherë dhe pa pasur mundësi të sigurojnë kushtet minimale të jetesës, në këto miniera janë punësuar dhe femrat. Disa punojnë dhe në stogjet e kromit. Punojnë këtu, se mund ta shohin si një punë më të lehtë se sa ajo që bëhet në minera ose mbase sepse mendojnë se është më pak e rrezikshme.

Por, stogjet e kromit kanë shënuar mjaft tragjedi. 45-vjeçarja, Lirie Mera ka humbur jetën duke punuar në këto stogje. Ajo ishte nëna e tre fëmijëve. Vështirësitë ekonomike dhe pamundësia e të shoqit për të punuar për shkak të një sëmundje fizike e kishin shtyrë të kërkonte një punë për të mbajtur familjen e saj. Kërkonte vetëm të fitonte ca para për të siguruar bukën e gojës, për të ushqyer fëmijët e saj, por e vetmja gjë që mori në këmbim ishte vdekja. Për shumicën është një histori e harruar, por për familjen e saj është ende një plagë e hapur, një plagë që ende dhemb dhe dhimbja bëhet më e fortë kur sjell në mendje mënyrën se si ajo

vdik. Po çfarë ndien familja e saj? Si e përjetuan dy vajzat vdekjen e nënës së tyre? Si e morën vesh lajmin për vdekjen e saj?

Njëra nga vajzat quhet Leonora dhe është vetëm 19 vjeç. Asaj i duhej që në këtë moshë të përballej me humbjen e të ëmës. "Mami ishte zgjuar shumë herët si ditët e tjera, i bëra gati mëngjesin dhe dola ta përcillja. Kishte bërë vetëm dy hapa dhe ktheu kokën, më pa, buzëqeshi dhe pastaj u largua. Unë e përshëndeta dhe u ktheva në dhomën time të fliji dhe pak. Në fillim nuk e mendova, por pastaj m'u duk e çuditshme mënyra më të cilën mami u largua. Nuk më kishte buzëqeshur asnjëherë si atë ditë, por unë nuk dija se çfarë do të vinte më pas. Nuk e dija se nuk do ta shihja kurrë më"- tha Eleonora dhe në lotët e saj shihej një dhimbje e pafund. Mesa duket nëna e saj



e kishte ndjerë atë që po vinte, e kishte ndjerë se mbase kjo ishte hera e fundit që po e shihte vajzën e saj. Më pas ajo shtoi: "Nuk e kisha menduar kurrë se mamaja ime do vdiste në këtë mënyrë, aq më tepër në këtë moshë. Duket e çuditshme por unë e shihja mamanë time si një njeri të



pavdekshëm dhe në momentin kur mora vesh atë që kishte ndodhur, e gjithë bota ime u shemb. Mori fund gëzimi dhe dëshira ime për të jetuar. Doja vetëm të vdisja, të isha pranë saj. Por, nuk mundesha, duhet të kujdesem për motrën dhe vëllain, por mbi të gjitha për tim atë. Tani ata janë arsyeja e jetës sime.” Në fund ajo tha: “Nuk ka dhembje më të madhe për një fëmijë se sa humbja e një nëne. Sado që mund të qeshësh apo luash me të tjerët, kjo është vetëm një maskë, sepse nga brenda ai vuan, ndjen aq shumë dhimbje, të cilën vetëm ai që e ka përjetuar në kurriz të tij arrin ta kuptojë. Ndonjëherë është më mirë të jesh i uritur, sepse të paktën je i sigurt që mamin e ke afër, por kur ajo ikën për të punuar, për të mbledhur ca gurë kromi, nuk e ke sigurinë se do kthehet sërish”.

Por ajo nuk ishte personi i vetëm që gjeti vdekjen në stogjet e kromit. Para dy vitesh një grua tjetër, 47-vjeçare, nënë e tetë fëmijëve, gjeti vdekjen si pasojë e shembjes së një masivi kromi. Dhjetra gra përballen çdo ditë me vdekjen. Njëra prej tyre e quajtur Zenepe Viçishta rrëfen: “Unë kam afërsisht shtatë vite që bëj këtë punë. Vij të mbledh krom që në gjashtë të mëngjesit dhe mbaroj në katër të pasdites dhe nuk ka ditë që nuk kam frikë. Para se të dal nga shtëpia, i takoj gjithmonë vajzën dhe djalin si të ishte hera e fundit që i shoh. Në këtë vend mundësia e vetme për të mbijetuar është të nxjerrësh nga thellësia e tokës krom dhe në këmbim të marrësh ca qindarka. Nëse duam të mbijetojmë duhet ta bëjmë këtë duke luftuar çdo ditë kundër vdekjes”.

Bulqiza, me një thesar nëntokësorë është bërë një strehë konfliktesh, ku krahas frikës dhe tensionit të aksidenteve në thellësitë e nëntokës, ndeshesh me zënkat mes personave që pretendojnë se janë pronarë, e që shfrytëzojnë të mitur, të pafajshëm, jetimë dhe të varfër. Kushtet ekonomike dhe dëshira për mbijetesë i detyron të bëhen skllëvër të pronarëve “kukulla”. Realisht, ata nuk



kanë asnjë dokument që jua njih këtë të drejtë. Firmat private janë kthyer në ferr për këta qytetarë të thjeshtë që shfrytëzohen pa mëshirë. Minatorë që punojnë në punë të zezë me një pagë qesharake takon kur ecën rrugëve të qytetit, pa asnjë kontratë pune apo sigurime shoqërore. Kjo tregon faktin e dhimbshëm se ato mund të punojnë për vite me radhë në këto institucione private dhe puna e tyre të mos vlerësohet, pasi nuk janë të siguruar dhe pagat në të shumtën e rasteve nuk i marrin në kohën e duhur, siç ndodh me pusin qendror, që është nën kujdesin e shtetit.

Minatorët e pakualifikuar dhe mosha tepër e re që punojnë në këto institucione private për vendosjen e lëndëve plasëse të kromit, shpesh është shkak i shumë incidenteve të ndodhura, me një licencë punojnë deri në katër pronarë dhe porta hyrëse në thellësi është e njëjtë për të gjithë. Shpesh, privatët për t'i udhëzuar të rinjtë në punë në drejtimin e tunelit (pa patur idenë e asnjë hartë drejtuese për këto tunele), shfrytëzojnë përvojën e pensionistëve në këto miniera kromit.

Në të shumtën e rasteve, lidhjet miqësore në qytetin e vogël të Bulqizës çojnë në fshehjen e padrejtësive që bëhen ndaj minatorëve pa përvojë. Përhapja e minierave private vitet e fundit dhe mosekzistenca e asnjë kushti sigurie është kthyer në një fobi për marrjen e jetës së të pafajshmëve.

Renditemi në vendin e parë në Europë dhe vendin e tretë në Europë për nxjerrjen e mineralit të kromit, mendojmë vetëm për pasuri, por a kemi menduar ndonjëherë për ata që i nxjerrin në sipërfaqe? A kemi menduar për mundin dhe sforcën e tyre, për kurajon e tyre? Në të vërtetë jo, rëndësinë e tyre e kuptojmë vetëm kur ata nuk janë më. Por, atëherë është shumë vonë.





Nga Ilda Shytaj dhe Luis Bekteshi

Tiranë, një në pesë dyqane vidhen



Qytetari ↔ (Produkti + Shërbimi) = {Të jemi sa më afër}

Të ecësh në trotuaret e rrugëve të Tiranës është një aventurë. Rrugëtimi në një trotuar të drejtë nuk shoqërohet nga një ecje vijëdrejtë. Zigzage të shumta zgjasin rrugën tonë dhe kjo vjen nga territori që zaptojnë bizneset në trotuare. Të gjithëve na ka ndodhur të mbledhim gjatë rrugës sende të paplanifikuara: një manekin të del përpara e bie sy me sy me ty sikur të thotë `merrmë`; një e moshuar që shet perime bio e që sapo e sheh mendon që t'i blesh disa prej tyre e të mos e lësh të dridhet nga të ftohtët... këto tërheqin gjithmonë vëmendjen tonë. Pikërisht këto biznese, kioska, tezgjahë, stenda etj. i duam në rrugë, sa më afër, sa më shpejt. Jo rrallëherë mërmërisim nëpër dhëmbë se sa keq janë të rreshtuara, kur dalja jonë ka një qëllim tjetër për punë, kafe ose takime. Në dualitetin midis asaj që qytetarët duan çdo gjë poshtë shtëpisë dhe trotuareve të bukura dhe të lira, ekziston pakti i heshtur mes qytetarit dhe shitësit të shërbimit a të mallit “që të jemi sa më afër”. Sidoqoftë, problemi ynë do fokusohet në një tjetër temë. Këto produkte e shërbime kaq të ekspozuara a janë të sigurta? A pësojnë vjedhje bizneset? A ndihen të rrezikuar nga pasiguria e qytetit? A është dëmtuar monetarisht biznesi i tyre?


Për të paraqitur një panoramë sa më konkrete dhe reale rreth sigurisë së këtyre bizneseve, artikulli u bazua në një anketim. Në të u pyetën 200 biznese në katër rrugët e Tiranës: në rrugën “Ibrahim Rugova,” nga kompleksi “Taiwan” deri tek Libri Universitar, rruga “Petro Nini Luarasi”, pjesa e tregut elektrik, rruga “Lord Bajron” si edhe rruga “Don Bosko.” Kryesisht, janë pyetur menaxherë të bizneseve, pronarë dhe punonjës. Bizneset ishin të ndryshme, si për shembull: mini-markete, kozmetike, filiale këmbimi valutor, filiale të operatorëve telefonikë, dyqane platforme televizive si dhe dyqane lulesh, veshjesh, fruta-perime etj. Arsyet e zgjedhjes së dyqaneve/bizneseve të ndryshme është edhe për të parë se cilat prej tyre janë më shumë viktimat e vjedhjeve.

1 nga 5 biznese në rrugë vidhen

Studimi në këto katër rrugë të përzgjedhura sjell fakte interesante. Sipas statistikave 1/5 e bizneseve janë përballur me raste vjedhjeje flagrante dhe të organizuara, 1/6 e tyre heziton të prononcohet për arsye të ndryshme, që do t'i sqarojmë më poshtë. Në zonën e tregut elektrik, spitalit ushtarak dhe afër zonës së bllokut, bizneset hezitojnë të thonë rastet e tyre të vjedhjeve. Kjo vjen më tepër për faktin se në dyqanet e këtyre rrugëve, ka më shumë shitës të punësuar për shitjen e mallit se sa pronarë apo administratorë të tyre. Shumë prej përgjigjeve ishin të njëjta: “Shefi/ja ka thënë të mos përgjigjem”, ose “Ne nuk dimë asgjë” ose “Mos na pyet ne” etj.

Mosbesimi është i dukshëm, disa thonë: “Çfarë do përmirësojë media këtu?,” “Nuk flas për mediat se herën e fundit që fola, më erdhi një grup kontrolli nga policia tatimore”. Ata hezitojnë për të denoncuar, sepse ata janë pjesë e një biznesi të pakontrolluar, që i paguajnë taksat jo rregullisht, por më së shumti ata i druhen gjobave të administratës tatimore ku shpesh janë shumë më të larta për xhiron që u mundëson biznesi i tyre.

Grupi i anketimit i kërkoi pronarit të një biznesi të vogël të plotësonte anketën e në ato momente erdhi një punonjës i policisë, i cili hyri furishëm dhe filloi duke i bërë pyetje dhe duke i kontrolluar dokumentet e biznesit. Pasi polici u largua, pronari hezitoi të plotësonte anketën dhe na kërkoi me mirësjellje që të largoheshim. Në momentet e para ai ishte i gatshëm që të ndante informacionin dhe nuk e kishte problem që të plotësonte anketën. Pasi u paraqit oficeri i policisë, sjellja e pronarit ndryshoi dhe ai nuk kërkonte të jepte më informacione. Fatkeqësisht, kjo tregoi një realitet të hidhur, ku njerëzit kanë frikë të prononcohen për mediat, nga frika se organet shtetërore mund t'i shkaktojnë probleme të ndryshme.






të lartë për sistemet e sigurisë ishte rruga “Ibrahim Rugova”. Por a janë më të sigurta këto biznese që kanë një sistem më të lartë sigurie? Duke u bazuar në përgjigjet e anketave, vihej re se bizneset që kishin pasur vjedhje me dëme materiale ose monetare më të larta ishin ato biznese ku sistemet e sigurisë ishin më të lartë. Por kjo nuk do të thotë që bizneset nuk duhet të kenë sisteme sigurie. Sistemet e sigurisë janë diçka e nevojshme për ruajtjen e biznesit, pasi kur një biznes nuk ka një sistem sigurie, ai është më i ekspozuar për të qenë pre e vjedhjeve. Pra, hapi i parë për të pasur një biznes më të sigurtë është vendosja e sistemit të sigurisë, në mënyrë që çdo gjë të jetë e monitoruar.

Pyetjes: “Në raste vjedhjeje, a keni denoncuar në polici? Bizneset preferojnë të heshtin.

Vjedhjet s`njohin kohë

Apriori mund të mendojmë se personi që vjedh zgjedh kohën për ta bërë këtë akt, ndoshta ditët pushim, në kohën e festave zyrtare gjatë natës. Por realiteti është ndryshe. Shumica e vjedhjeve të kryera kishin ndodhur gjatë javës. Edhe pse përgjigjet për kohën e vjedhjeve ishin të ndryshme, në anketë u zbulua një detaj i rëndësishëm. Shumica e të anketuarve që pranuan se kanë pasur vjedhje deklaruan se kishin qenë të pranishëm kur është kryer vjedhja. Ky është një fenomen shumë shqetësues për pronarët ose punonjësit e këtyre bizneseve, pasi jeta e rrezikohet seriozisht.



Sistemet e sigurisë për bizneset

Nga rrugët e zgjedhura, rruga “Ibrahim Rugova” mund të veçohet për sistemin e sigurisë, ku dallon më tepër përdorimi i kamerave. Gjithashtu, kishte biznese ku sistemet e sigurisë ishin më të komplikuar se sa thjesht përdorimi i kamerave. Në rrugët e tjera vihej re se sistemet e sigurisë ishin më të pakta dhe përdorimi i kamerave ishte i limituar. Gjithsesi, rruga që kishte një standart më

Për sa i përket dëmit, këto vjedhje variojnë nga më të thjeshtat deri te vjedhjet me vlera rreth 500 mijë lekë të reja. Edhe pse rastet e vjedhjeve flasin shumë, shitësit nuk raportojnë dëme në polici. Zonat në tregun elektrik kanë humbje më të mëdha në vlerë, ndërsa në rrugën “Don Bosko” shitësit ankohen për vjedhjet me vlera më të vogla, kjo si pasojë e llojit të biznesit që këto dy rrugë servirin. Hezitimi i pronarëve për të raportuar vjedhjet është një fenomen shumë shqetësues, pasi në njëfarë mënyrë, nxit që bizneset të bien pre e vjedhjeve të vazhdueshme. Në momentin kur ndodh një krim (sado i vogël të jetë ai), duhet të raportohet tek organet përkatëse. Komentet e pronarëve ishin të ndryshme se pse nuk i raportonin vjedhjet, por pika ku këto komente bashkoheshin ishte mungesa e besimit tek organet e policisë për zgjidhjen e krimit. Humbja e besimit tek organet policore është tragjike, pasi këto janë organet që shërbejnë për mbrojtjen e njerëzve. Raporti i policisë së shtetit në seksionin e garantimit të sigurisë publike të vitit 2011 tregon se janë 784 vepra penale të evidentuara më shumë se në 2010, gjithashtu tregon se kallzimet me anë të telefonit nga vitit 2010 në 2011 janë rritur me 23%. Në një farë mënyre bizneseve si edhe individët janë më të pritur të denoncojnë sot më shumë se sa në vitet e mëparshme bazuar në raportin e veprimtarisë së policisë së shtetit 2011 (janar 2012).




Nga Jolanda Lila



Mbi disa aspekte të komunikimit virtual

Interneti (përngjitje me shkurtime nga anglishtja “interconnection of networks”- “ndërlidhje e rrjeteve”) ka sjellë revolucion të vërtetë në formën e komunikimit, sepse ai ravijëzon tiparet e plota të multimedialitetit dhe të ndëraktivitetit. Këto dy karakteristika kanë rritur në përmasa gjiganteske numrin e përdoruesve të internetit në botë, sa që falë këtij mediumi sot bota konsiderohet si një fshat i vogël, ku distancat kohore dhe hapësimore shkrihen brenda një mikro/makrokozmosi virtual. Vetë fjala virtual lind si një kundërvënie ndaj fjalës real. Kjo nënkupton shfrytëzimit të hapësirave në rrjet. Ne mund të vendosemi në kontakt me çdo cep të globit dhe mund të përftohen një pafundësi ngjarjesh komunikative, të cilat mund të prodhohen çdo çast. Virtualiteti mundëson kapërcimin prej pengesave



dhe prej kufizimeve të realitetit të drejtpërdrejtë. Gjërat që nuk i prek dot fizikisht, i arrin në kohë reale vizualisht apo auditivisht përmes virtualitetit.


Elementi përbashkues mes virtuale dhe reales është konkretësia, e cila në rastin e parë preket përmes ekranit të kompjuterit, ndërsa në rastin e dytë perceptohet në formë të drejtpërdrejtë.

Përparësitë që ofron interneti kanë ndikuar fuqishëm në komunikimin ndërnjerëzor (sidomos të rinjtë), jo thjesht në përhapjen e mesazheve me natyrë informative, reklamuese, ndërgjegjësuese etj., por edhe në bashkëbisedimet virtuale.

Bisedat e gjata e të drejtpërdrejta po zëvendësohen me bashkëbisedimet në internet, duke asgjësuar distancat gjeografike dhe protokollet e orareve. Kjo thyerje konvencionesh sjell dobishmëri në aspektin praktik nga njëra anë, por nga ana tjetër krijon shumë problematika në



spektrin social dhe gjuhësor. Çështjet socio-psikologjike nuk janë objekt i vëzhgimit tonë, por po ndalemi në disa probleme të sferës gjuhësore.



Për të konkretizuar prirjen dhe specifikat e «të folurës kompjuterike» do të përqendrohemi te bashkëbisedimi në rrjet, ose chat-i,¹ duke qenë se ky lloj komunikimi është më i shpenguar dhe nuk lidhet me ligjërimin a korrespondencën zyrtare. Meqenëse bashkëbisedimi përmes internetit është zakonisht një mënyrë e shpejtë dhe spontane komunikimi. Këtu mbizotëron aksioma «e

1 Së bashku me përqafimin e mjeteve të zhvillimit teknologjik në vendin tonë kemi përvetësuar edhe termat apo shënjesit përkatës. Ky është një fenomen që ndodh në shumë vende, sepse kur një popull prodhon diçka të vlefshme për popujt e tjerë, të tjerët marrin jo vetëm atë material ose objekt, por edhe emërtimin për të, shpesh duke e përshtatur me sistemin fonetik të gjuhës marrëse. Pra, gjërat e reja vijnë me emra të rinj dhe këto sjellin jo vetëm risitë teknologjike, por edhe leksikore. Kështu, me përhapjen e internetit në Shqipëri, në gjuhën tonë kanë hyrë shumë fjalë që lidhen me këtë medium, duke nisur që nga vetë fjala internet, e duke vijuar me një pafundësi emrash e konceptesh që lidhen me të, si “chat”, “facebook”, “twitter”, “hotmail”, “yahoo”, “skype” etj., terma këto të ndërkombëtarizuara tashmë. Sigurisht, përballë këtyre termave është ndjekur natyrshëm rruga e huazimit, ku fjalët i janë nënshtruar rregullave fonetike të gjuhës burimore, në këtë rast anglishtes, ku fjala transferohet në gjuhën shqipe në mënyrë të paasimilueshme. Përveç formës grafike, ruhet edhe theksi i huaj i fjalës së huazuar dhe në varësi të shkallës së përdorimit në shqip orientohet edhe niveli i integritimit të këtyre fjalëve në kulturën shqiptare.

Hyrja e internetit (dhe derivateve që burojnë prej tij) ka përhapur një tipar të ri të natyrës së huazimeve në gjuhën shqipe: fjalët (në këtë rast emërtime të përveçme) vijnë në gjuhën shqipe pa u asimiluar dhe pa u përshtatur me sistemin fonetik dhe fonologjik të gjuhës shqipe. Fjala shkruhet dhe shqiptohet në përputhje me natyrën burimore, pa u adaptuar me gjuhën marrëse. E, pikërisht, kjo lind dy trajta përdorimore, ku herë shkruhet chat e herë çat, herë facebook e herë fejsbuk, etj. Duke qenë se fjalë të tilla janë me një status të papërcaktuar, sepse janë ende në proces asimilimi, u lihet në dorë përdoruesve të tyre që të vendosin se cili përdorim tingëllon më i natyrshëm tek ata.

shkruar baras me e folur”. Përdoruesit e këtij lloj komunikimi shkruajnë ashtu siç flasin dhe më tepër përqendrohen te përcimi i shpejtë i përmbajtjes, sesa te stolisja formale e shprehjes gjuhësore. Diskutimi bëhet në kohë reale dhe procesi i të shkruarit nuk udhëhiqet nga stadet e logjikës së krijimit, por nga thëniet që ndjekin njëra-tjetrën në formë lineare. Bashkëbisedimi realizohet në formë ndërvepruese dhe të njëkohshme, ku njëri folës prodhon një thënie dhe pasi marrësi e kupton këtë thënie reagon në mënyrë fjalësore, ose jofjalësore², kështu vargëzohen disa thënie që lidhen reciprokisht sipas parimit të “varësisë së kushtëzuar” (për shembull çifti “pyetje-përgjigje”). Ky parim ka në thelb rendin e të folurit e jo atë të të shkruarit, sepse njëlloj si dialogët e bisedat e drejtpërdrejta verbale, zhvillohet edhe biseda virtuale. Karakteri bisedor i këtyre thënieve të

shkruara gjuhësore e varfëron gjuhën shqipe në tri aspekte kryesore: në aspektin semantik, në atë sintaksor, por edhe në çështje drejtshkrimore dhe në (mos) përdorimin e shenjave të pikësimit. Ndryshe nga të shkruarit e letrave, në gjuhën e bisedës përmes internetit, strukturimi formal i shprehjes gjuhësore është më i çliruar nga rregullat.

Në aspektin semantik vihen re tri prirje kryesore: shkurtesat, trajtat dialektore (ose zhargoni) dhe përsëritjet, pra varfëria e fondit fjalësor.

Duke qenë se dhënësi i informacionit synon dërgimin sa më të shpejtë të mesazhit te marrësi ndeshen shprehje e fjalë në formë të shkurtuar, të cilat zakonisht paraqiten përmes inicialeve të sintagmave, ose tingujve që gjenden në trup të fjalës. Raste të kësaj natyre, janë shkurtesa të tipit: spk (në vend të “si po kalon”), flm (në vend të fjalës



“faleminderit”), mf (“me një fjalë”), klm (“kalofsh mirë”), sh (shumë), tl (të lutem) etj. Këto kode gjuhësore të gjuhës së chat-it janë tërësisht të deshifrueshme nga të rinjtë dhe përdoruesit e bashkëbisedimeve elektronike në përgjithësi. Dekodifikimi i shkurtesave ka arritur në atë shkallë, sa që “natyrshëm” janë bërë pjesë e sistemit komunikues

2 Te reagimet jofjalësore kemi parasysh simbolet ndërkombëtare të shprehjeve emocionale (- i lumtur, - i mërzitur, - i habitur etj.); reagimet me anë të shenjave të pikësimit, si p.sh. përdorimi vetëm i pikëpyetjes (?) kur diçka është e paqartë, ose për zëvendësimin e formës pyetëse “pse”.

edhe shkurtesat prej gjuhëve të huaja. Këto shkurtime janë huazuar masivisht prej anglishtes, por edhe prej italishtes, për shkak të kontakteve më të shpeshta dhe

klm pls flm4you

të shumta që shqiptarët kanë me këto dy kultura vitet e fundit. Kështu, shkurtesa të huazuara me përdorim të gjerë në bashkëbisedimin në internet janë: thnx (thanks), 4you (for you), ok (okey), pls (please) etj.; janë edhe huazimet e fjalëve të huaja në vend të fjalëve shqipe: sorry (më fal), ciao (mirupafshim), hi (përshëndetje), x (për), 1x (një herë), tvb (ti voglio bene), sms (mesazh), like (pëlqej) etj.

Bashkë me shkurtesat e fjalëve dhe sintagmave shqipe e të huaja, shpesh gjuha e chat-it karakterizohet edhe nga trajtat dialektore të të shprehurit, si: ça bane? (çfarë bëre?), he mo lale, hik tashi (ik tani), kshu (kështu), nigjo içik (dëgjo pak). Njëherësh shihen prirje të përdorimit të zhargonit të studentëve e të të dashuruarve, veçanërisht tek emërtimet dhe shprehjet zbnuese, si p.sh.: puç folt (të puth fort), xemla logël (zemra e vogël), kukla e bukul (kukull e bukur), nam fare, piti (shpirti) etj.

Përdorim më të gjerë ka përdorimi i e-së në vend të ë-së dhe përdorimi i c-së në vend të ç-së. Ky përdorim i kushtëzuar, kryesisht, për shkak të sistemit të huaj të tastierës së kompjuterit, tashmë po fiton terren, duke u kthyer në "normë", për shkak të përdorimit edhe për shkëmbime mesazhesh, e-mailesh, por edhe korrespondencash zyrtare. Këto zëvendësime rrezikojnë seriozisht sistemin semantik të gjuhës shqipe dhe kambanat e alarmit kanë rënë prej kohësh nga gjuhëtarët. Në shumë raste fjalët e shkruara pa ë-në apo ç-në krijojnë ambiguitet kuptimor, i cili bëhet i deshifrueshëm vetëm nga konteksti, si p.sh.: cek-çek,

kuptoje- kuptojë, ne- në etj.

Në planin sintaksor frazat ndërtohen sipas shtampave të gatshme të ligjërimit bisedor, në të cilat kemi mungesë tingujsh, foljesh, emrash dhe shpesh struktura tejet të hallakatura. Gjuha e chat-it nuk i nënshtrohet sistemit, por shkon kah ligjërimi dhe pikërisht kjo e deformon stilin e të shkruarit. Thuajse kurrë nuk respektohet skema klasike sintaksore: kryefjalë-kallëzues-rrethanor, madje edhe frazat paraqiten me shkurtime, ose në trajta dialektore, si p.sh.: "m co 1 çerre kur t dalesh", "m prit 10 min", "ka sh trafik rrugs", "ok", etj. Masivizimi i përdorimit të shprehjes "ok" ka sjellë edhe disa ndërtime sintaksore të huaja në gjuhën tonë, si: "a je okej?", "më jep okejin", shprehje të cilat përdoren edhe në radio e televizione dhe jo thjesht në bashkëbisedimin e ngushtë mes dy personave në internet.

Situata sintaksore bëhet akoma më kaotike, nga mosrespektimi në rastin më të mirë dhe në rastin më të keq, nga mospërdorimi i shenjave të pikësimit, ku mesazhi bëhet i vështirë për t'u kuptuar. Rast tipik është p.sh. ndërtimi i frazës "është mirë", ku përveçse si konstatim pohues, mund të paraqitet edhe si pyetje (duke

nënkuptuar pyetjen "a është mirë?", edhe pse karakteri pyetës nuk shfaqet në asnjë element (as tek pjesëza pyetëse a dhe as në përdorimin e pikëpyetjes në fund të frazës). Ndërtime të tilla sintaksore e rrezikojnë shqipe, mbi të gjitha kur konstatojmë se këto përdorime nuk mbeten të izoluara brenda suazave të komunikimit ndërpersonal në internet, por shtrihen edhe në komunikimet mediatike.

Jemi të vetëdijshëm se gjuha është një organizëm i gjallë që zhvillohet bashkë me njeriun, por fenomenet dhe problematikat e të folurit nuk duhet të ndikojnë në sistemin e shqipes standarde. Të gjithë duhet të rrisim më tepër nivelin e autocensurës kur shkruajmë, pavarësisht nëse jemi në chat, apo duke përgatitur një kumtesë.

Kjo ishte një trajtesë e disa prej aspekteve përbërëse të gjuhës së chat-it, e cila na ndërgjegjëson se përdorimi i shprehive jostandarde, të cilat molepsen ditaditës, shkakton varfërimin e gjuhës shqipe dhe cenon strukturën sintaksore të saj. Gjuha e folur nuk është e barabartë me atë të shkruarën, prandaj teksa nxijmë fletën e bardhë, apo shtypim shkronjat mbi tastierë, të respektojmë parimet e të shkruarit dhe jo të imitojmë të folurit.





Ka shumë arsye përse duhet të lesh alkoolin.

Gjej tënden!



Nga Oltjon Albajrami



Migrena, femrat më të rrezikuara

Migrena është sëmundje që shihet në 12-16 për qind të popullsisë. Ajo shkakton paaftësi të konsiderueshme në aspektin funksional dhe jetën sociale të individit. Edhe pse është relativisht i përhapur, diagnostikimi dhe trajtimi i kësaj sëmundjeje shpesh është i gabuar ose i pamjaftueshëm. Migrena prek më shumë gjininë femërore. Raporti femër-mashkull të prekur nga migrena



është 3:1. Ajo përfshin grupmoshat nga 12 deri në 45-50 vjeç. Në shumë raste, migrena ka lidhje gjenetike, një ose më shumë antarë të së njëjtës familje vuajnë nga kjo sëmundje. Fillimisht mendohej se migrena shkaktohet nga zgjerimi i damarëve të gjakut në cipat e trurit, por studime më të detajuara nxorrën në pah një mekanizëm më kompleks e gjithëpërfshirës të sistemit nervor. Edhe pse një dhembje shumë e fortë e kokës, fatmirësisht, në më të shumtën e rasteve, kjo sëmundje nuk predisponon rrezikshmëri për jetën.

Simptomat

Shumica e pacinetëve kanë dhembje koke të forta. Në këtë mënyrë, ata detyrohen të tërheqen nga ambientet sociale. Dhembja e kokës së migrenës fillon gradualisht, intensifikohet brenda pak minutave, zgjat një ose më shumë orë dhe largohet gradualisht në fund të sulmit. Dhembja është e fortë, pulsuese, e lokalizuar në njërën



anë të kokës. Ajo ka ndjeshmëri ndaj dritës, zhurmës. Ata që vuajnë nga migrena mund të kenë përzjerje të stomakut e të vjella. Gjatë sulmit të migrenës, individit preferon të qendrojë në një dhomë të errët, larg zhurmës dhe i izoluar. Përveç simptomave të mësipërme, 10 deri në 20 për qind e pacientëve shfaqin aura, të cilat janë simptoma më serioze si p.sh.: rrathe drite apo vija të ndritshme përpara syve, ndryshime në shikim si dhe mpirje të një pjese të fytyrës apo gjymturëve . Aurat zgjasin jo më shumë se 60 minuta dhe disa studime të botuara së fundmi kanë zbuluar se ato janë të shoqëruara me një rrezik disi më të lartë për sëmundjet kardiovaskulare si infarkti kardiak apo iktusi cerebral.


Shkaqet e migrenës

Janë të shumtë faktorët që mund të shkaktojnë migrenën, si për shembull: stresi, lodhja, mungesa e gjumit, uria, periodat menstruale, koha e ftohtë, përdorimi i duhanit, aroma e parfumeve si edhe aromat e tjera të forta të substancave të ndryshme kimike. Në kategorinë e ushqimeve, studimet tregojnë se përdorimi i alkoolit, shampanjës, bulmetit, ushqimeve të konservuara, çokollatave si edhe mospërdorimi i kafesë janë shkaqe të shfaqjes së sëmundjes së migrenës. Në diagnostifikimin e migrenës nuk është e nevojshme imazheria, si p.sh. rezonanca magnetike apo tomografia e kompjuterizuar, me përjashtim të rasteve kur shfaqen simptoma për sëmundje dytësore të trurit, si tumoret cerebrale apo infeksionet e trurit. Konsultimi me mjekun familjar do të parandalonte një diagnostifikim të vonuar në raste të tilla.



Terapia

Sëmundja e migrenës shkaton orë të gjata mungese në punë si edhe shmangien e aktiviteteve sociale. Hapi i parë në parandalimin e migrenës është shmangia e faktorëve që e shkaktojnë atë. Shumë herë, ky hap nuk është i mjaftueshëm. Si rrjedhim, individit që ka shenja të kësaj sëmundjeje duhet të përdor ilaçe. Duhet theksuar se ilaçet e migrenës duhet të përdoren në momentin e parë që pacienti ndjen fillimin e dhembjes së kokës. Kështu parandalon përkeqësimin e saj dhe redukton sasinë e ilaçeve që duhet të përdoren për ta ndaluar atë. Dhembja e kokës do të kalojë pa përdorimin e ilaçeve është mendimi i gabuar dhe e bën të vështirë trajtimin. Ilaçet që përdoren zakonisht janë paracetamoli, naproxeni dhe ibuprofeni të kombinuara me kafeinë ose jo. Nëse sulmet e migrenës ndodhin më shpesh se 2-3 herë në muaj rekomandohet përdorimi i ilaçeve për të rralluar sulmet. Këto ilaçe merren rregullisht çdo ditë për 6-12 muaj dhe mund të ndalohen në varësi të përgjigjes së sëmundjes. Vizitat periodike te mjeku i familjes dhe edukimi i pacientit është çelsi i suksesit.



*“Poezija nuk krijohet me metoda,
me slogane politike, me urdhëra.
Poezija do liri, nuk merrem me
politikë. Kam frikë se po të shkruaj
do të bëj gabime ideologjike,”*



Nga Hasan Bello




Lasgush Poradeci, raportet e poetit me diktaturën

Pas librit me kujtime të poetit, përkthyesit dhe arkitektit të mirënjohur Petraq Kolevica me titull “Lasgushi më ka thënë”¹, një tjetër libër po aq i bukur dhe me vlera të rralla për memorialistikën dhe historinë e letërsisë shqipe vjen për lexuesin nga regjisori dhe intelektual i pogradecar Tomi Mato. Libri titullohet “Të vërteta të pathëna për Lasgushin”² dhe e ka parë dritën e botimit për herë të parë në dhjetor të vitit 2010. Autori, si një nga miqtë që ka pasur fatin dhe mundësinë për ta njohur nga afër lirikun e poezisë shqipe në ditët më të vështira të jetës së tij, afërsisht në pesëqind faqe, me një stil tërheqës dhe plot rrjedhshmëri pasqyron qartë anët e panjohura dhe kalvarin e vuajtjeve të poetit më të madh shqiptar në vitet e diktaturës komuniste.

Diktatori dhe poeti

Në një ditë vere të vitit 1983, ndërsa poeti së bashku me miqtë e tij shëtisnin në Volorekën e mbushur me familjarë që kishin ardhur aty për piknik, befasisht ishte shfaqur Enver Hoxha me Nexhmijen. Turma e ekzaltuar kishte shpërthyer në britma hysterike “Parti Enver, jemi gati kurdoherë” dhe duke kënduar këngën “Enver Hoxha e mprehu shpatën”... Tomi Mato shkruan se në ato momente e kishte pushtuar një ndjenjë sedre. Të gjithë brohorisnin, ndërsa ai rrinte indiferent, ndonëse ishte komunist e duhet të jepte shembullin i pari. Poeti, i cili e kishte zbuluar gjendjen tij shpirtërore, kishte ndërhyrë me fjalët:

- “Ti, Mato shko, mos më shiko mua. Unë jam plak pa parti, ti je me nofuskë të kuqe në xhep.
- Hajde bashkohemi edhe ne me turmën – i propozova Lasgushit.”



Por ai m’u afrua tek veshi dhe më tha: “Unë nuk dua ta shikoj Veron, as dua të më shikojë. Kam 43 vjet që e kam njohur qeratanë. U njohëm në gjimnazin e Tiranës në vitin 1937. Unë isha 12 vjet më i madh, isha më i shkolluar, kurse Verua erdhi nga Parisi, ashtu, “Tabula rasa” (Fushë e rrafshuar, nul). Kolegët e tallnin, tutkun, i thoshin: Të kanë vajtur këmbët e jo koka në Paris. T’i shtrydhën trutë putanat... Mua më vinte keq. E shoqëroja, e kupton, më vinte keq ndaj e shoqëroja se të tjerët ishin larguar. Një ditë se ku i kishte gjetur dy librat e mi “Vallja e Yjeve” dhe “Ylli i

1 Petraq Kolevica, *Lasgushi më ka thënë*, Tiranë: “Toena”, 1999.

2 Tomi Mato, *Të vërteta të pathëna për Lasgushin*, Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2010.

zemrës.” Më tha disa vjersha përmendësh prej tyre dhe më u lut që t’i shkruaja diçka me dorën time në libër dhe ai ta kishte si kujtim nga njeriu që iu gjind kur të tjerët iu larguan. Ia shkrojta. Ai më përqafoi dhe më ftoi për darkë në shtëpi.

Tri herë më ftoi por nuk i vajta. Kolegët më thanë të mos i shkoj se ka një huq të keq që...”³³

Megjithëse çdo vit diktatori shkante në Drilon për pushime, asnjëherë nuk ishte kujtuar për ta takuar poetin. Aq më tepër (siç deklaroi dhe më sipër Lasgushi), që ata njiheshin qysh në vitet 30-të, atëherë kur të gjithë e kishin braktisur “Veron.” Si për çudi, pas vdekjes së poetit në vitin 1987, dy vite e shtatë muaj pas vdekjes së diktatorit, në muzeun e qytetit të Pogradecit vjen një letër e dërguar nga Nexhmije Hoxha. Letra kishte si titull “Nga kujtimet e shokut Enver për Lasgush Poradecin”, ku ndër të tjera thuhet: “U interesova për Lasgushin pranë shokëve të Partisë dhe më thanë se është mirë me shëndet. Jam interesuar për të, rron në një shtëpi komode të tijën, tok me çupën. Shokët më thanë se ka shkruar dhe një vjershë për Kosovën. U gëzova. Lasgushin e kam njohur që para lufte, kur isha profesor në gjimnazin e Tiranës. Më kujtohet se veprat e tij i përpunonte në mënyrë metikoloze (me merak). Ishte ca pesimist në jetë, por jo në vjershat e tij. Ai ishte i dëshpëruar nga regjimi i Zogut, prandaj preferonte të jetonte i vetmuar. Dikur dilte dhe bashkohej me ne.” Midis të tjerash në letër shkruhet: “...t’i japin të falat e mia Lasgushit dhe t’i thoni që unë ruaj kujtimet më të mira për të.”⁴⁴ Me të drejtë, Tomi Mato shkruan se kjo letër e datës 28 gusht 1981 po bëhej e njohur pas vdekjes së poetit, sigurisht për të realizuar qëllimet e planifikuara më parë, për të fallsifikuar historinë, për “respektin” që Enveri paska pasur për poetin.

Shkrimtarët oborrtarë të diktaturës dhe poeti

Pas instalimit të diktaturës komuniste, letërsia shqipe kishte përqaftuar parimin leninist, duke i vënë vetes si detyrë kryesore: “pasqyrimin e heroizmit dhe hovit revolucionar të masave në luftë për ndërtimin e bazave të socializmit.”⁵⁵ Lasgush Poradecin kishte mbajtur një “qëndrim indiferent” gjatë luftës, duke mos e vënë yllin e kuq në kapele si Dhimitër Shuteriqi, Shefqet Musaraj, Fatmir Gjata, Sejfulla Malëshova etj. Pavarësisht se për luftën kishte krijuar dy balada kushtuar vëllezërve Muharrem⁶⁶ dhe Reshit Çollaku⁷⁷, filloi një epokë e re. Megjithëse ishte poeti më i mirë i kombit shqiptar u përpoqën ta mënjanonin, denigronin dhe zvogëlojnë. Ndër të parët

³ *Po aty.*, f.106-107.

⁴ *Po aty.*, f.108-109; Kjo letër është botuar në gazetën “Driloni” nr.41, 22 dhjetor 1988, f.1, organ i Komitetit të Partisë së Rrethit, koleksioni i së cilës gjendet dhe në Fondin e Bibliotekës Kombëtare në Tiranë.

⁵ *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, Tiranë: Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1978, f.74.

⁶ *Lasgush Poradeci-vepra letrare*, Tiranë: Naim Frashëri, 1990, f.293.

⁷ *Po aty.*, f.297.



LASGUSH
PORADECI
1899-1987

që e filloi këtë fushatë ishte ish-ministri i Kulturës dhe kryetari i parë i Lidhjes së Shkrimtarëve Sejfulla Malëshova, duke e akuzuar si “Zog liqeni”, si “Poet të shitur te Zogu” etj. Kjo e revoltoi tej mase poetin dhe e shtyu t`i shkonte në zyrë Sejfullait, i cili nuk ishte ngritur nga kolltuku që t`i jepte dorën. Duke iu gërhushur e kishte pyetur Sejfullain: “Nga e di ti që unë u shita te Zogu?...Si guxon ti të shkruash se Lasgushi hyri në pellgun oportunist të intelektualëve dhe u bë poet dallkauk? E mbërtheva si Krishtin në kolltuk. Duke ikur i thashë: “dëgjo këtu Sejfulla, ti çdo gjë mund të më marrish, se je hypur në kalë, po nderin tim si poet shqiptar nuk mund të ma marrësh”⁸

Në fjalën e redaksisë së revistës së Lidhjes së Shkrimtarëve “Literatura jonë” (emër i kopjuar nga simotra ruse) nr.1 të vitit 1947, duke aluduar drejtëpërsëdrejti mbi Lasgushin shkruhej: “Ka pasur gjithashtu shkrimtarë të cilët, edhe duke mos bërë krushqi drejt për drejt me armiqit e betuar të vendit, kanë kënduar si gjinkalla në lëmë, yjtë, hënën, zambakun, etj, duke mos i shërbyer popullit për kauzën e tij, por duke i rënë legenit atëherë kur ky luftonte, vritej e digjej për liri e pavarësi”⁹

Në tetor të 1949 në Konferencën e III të Lidhjes së Shkrimtarëve, Sejfulla Malëshova u dënua dhe u sulmua ashpër me urdhër nga lart. Dhimitër Shuteriqi, i cili zëvendësoi S. Malëshovën si Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve, në fjalën e tij të hapjes deklaroi ndër të tjera: “Ne sot jemi të lumtur që kemi mundësinë t`i shtrojmë drejt çështjet e trashëgimit tonë letrar, pa ferra të tilla në këmbë si megalomania oportunistit

S.Malëshova.”¹⁰ Kush kërkon t`ia bëjë varrin tjetrit, bie vetë në të. Një shembull i ngjashëm, si ky që përmendëm më lart, vlen të përmendet përsëri. Në Konferencën Nacionale të letrarëve të rinjë të vitin 1950, shkrimtari i ri komunist Mark Ndoja, në diskutimin “Brendia e forma në letërsi” godiste Lasgush Poradecin si formalist dhe si poet pa ideologji. Gjithashtu u bënte thirrje të rinjve që të ruheshin prej formalizmit si prej kolerës. Më pas merrte në shqyrtim disa vargje të tij dhe parodizonte me fjalët: “Lasgush, ti mendjen po na lasgushon!”¹¹ Por nuk zgjati shumë, edhe Mark Ndoja përfundoi në burg.

Përse nuk shkroi më Lasgushi pas 1945?

Sipas tij “poezija nuk krijohet me metoda, me slogane politike, me urdhëra. Poezija do liri, nuk merrem me politikë. Kam frikë se po të shkruaj do të bëj gabime ideologjike.” Ai shpesh thoshte se: “Unë jam poeti i rinisë, dashurisë, liqenit, natyrës”. Lasgushi e theu penën, nuk pranoi të vihej nën shërbim të “oborrit mbretëror”, prandaj me të drejtë, ai mund të quhet si i pari disident i letrave shqipe. Kjo është ajo përballë kohës ku u shkruan që në të vërtetë mund të quhen disidencë artistike. Si poet, me të drejtë Eqerem Çabej në artikullin “Mbi poezinë e Lasgush Poradecit” të botuar në “Gazetën e Re” më 22 shkurt 1929 ka shkruar: “Lasgush Poradeci, të cilin një fat i mirë duket ia ka falur Shqipërisë që të bëhet Ai shkrimtari, të cilin Shqipëria, do t`ia ja falë një herë botës”¹²

8 ⁸ Tomi Mato, *vep., e cituar*, f.380-381.

9 ⁹ *Literatura jonë*, Tiranë 1947, nr.1, f.4-5.

10

¹⁰ *Literatura jonë*, Tiranë 1950, nr.7, f.45-46.

11

¹¹ *Letrari i ri*, 15 shtator 1950, f.2.

12

¹² *Gazeta e Re*, 22 shkurt 1929, f.3.





Nga Ejup Lila



Emotiv EPOC EEG

Komunikimi që ne kemi me makineritë është i kufizuar. Duke filluar që në ndezjen e një drite elektrike ne kemi nevojë për një çelës. Ne duhet t'i japim makinerive një komandë ose një sërë komandash në mënyrë që ajo të kryej atë çfarë ne kërkojmë. Nga ana tjetër, edhe komunikimi mes njerëzve është shumë kompleks. Gjithmonë ne kuptojmë më pak ose më shumë nga ato që na thuhet. Kjo vjen si pasojë e gjuhës së trupit, ndjenjave, emocioneve, fjalëve që ne përdorim dhe shumë shkaqe të tjera.

Shkencëtarët po përpiqen për t'i kapërcyer këto barrierë. Bëhet fjalë për një aparat me sensorë i quajtur *Emotiv EPOC EEG* që vendoset në kokë. Ky aparat është i aftë të marrë informacione nga sipërfaqja e trurit. Kjo lidhje mes trurit dhe pajisjes bën të mundur që veprimet që duhet të bëjmë ne apo mendimet tona të përcillen pa u



shprehur dhe pa lëvizur. Përcjellja e mesazhit arrihet me lidhjen **wireless** të Emotiv me pajisjet e tjera si televizor, kompjuter, playstation, apo shumë makina të tjera elektronike. Me anë të *Emotiv* mund të luajmë futboll në kompjuter pa përdorur komandat. Mjafton të mendojmë se ku duhet ta dërgojmë topin dhe *Emotiv* na e bën të mundur.

Ky aparat mendohet të përdoret gjerë edhe nga njerëzit e kufizur fizikisht. Karroca e invalidëve mund të përdoret pa lëvizur duart, mjafton që invalidi të ketë mendimin e qartë se nga duhet të kalojë. Gjithashtu, *Emotiv* mund të kuptojë edhe gjendjen emocionale. Mjafton një lidhje mes aparatit dhe pajisjeve ndriçuese në shtëpinë tuaj dhe *Emotiv* ndryshon ngjyrat sipas gjendjes suaj emocionale. Këto janë vetëm disa shembuj nga shumica e fushave ku mund të përdoret *Emotiv*.

Tabletat dhe risitë

Tabletat mund t'i quajmë kompjutera celularë. Këto pajisje punojnë me prekje (me gisht) ose me majë shkruese në formë lapsi. Tastiera e tabletave është e fshehur dhe shfaqet vetëm kur ajo nevojitet për të futur të dhëna në tabletë. Ato zakonisht ofrojnë një ekran me madhësi diagonale më të madhe se 7 " (18cm).

Po të shohim, numri i tabletave po rritet dita-ditës. Nga statistikën e fundit vërehet se ato kanë pasur një rritje të ndjeshme ndaj kompjuterave dhe smartphoneve. Në grafikun e mëposhtëm do shohim numrin e kompjuterave, laptopëve dhe tabletave të shitura në rang botëror ndër vite dhe gjithashtu, parashikimin se si do jetë numri i tyre deri në vitin 2015. Në vitin 2010 numri i tabletave të shitura arriti në 19 milion. Ky numër është i vogël në krahasim me atë të laptopëve që ishte 200 milion dhe të kompjuterave që ishte 157 milion. Në vitin 2011 numri i tabletave të shitura arriti në 70 milion ndërsa numri i kompjuterave dhe laptopëve pothuajse varion në të njëjtat numra. Në vitin 2012 numri i tabletave shkoi në 133 milion. Këtë vit parashikohet që numri i tabletave të arrijë në 216 milion. Sipas parashikimeve çdo vit do ketë një rritje prej 70 milion tabletash. Në bazë të këtij parashikimi, në vitin 2014 do të kemi 282 milion dhe


në vitin 2015 do të kemi 352 tableta të shitura. Ndërsa numri i kompjuterave dhe notebookëve do varioi pothuajse në të njëjtat shifra.

Kjo rritje e numrit të tabletave vjen si pasojë e avantazheve që ato kanë. Njerëzit nuk kanë nevojë të presin apo të dalin të marrin gazetën e përditshme, por me një klik ata mund ta hapin nga tableta e tyre. Nuk është e nevojshme të merrni libra kudo që të shkoni. Ato mund t'i kenë në tabletën tuaj. Për t'u ndjerë sa më komod, ju mund të ndryshoni madhësinë e shkrimit dhe të ulni ose të rrisni ndriçimin e faqes. Ato kanë dizajnë tërheqës, peshojnë më pak se laptopët dhe mund të transportohen shumë lehtë. Mjafton një çantë dore dhe tabletën tënde mund ta marrësh gjithmonë me vete. Ekranin është shumë i ndjeshëm, mund ta kthesh horizontalisht apo vertikalisht sipas nevojës. Detyrat e papërfunduara mund t'i vazhdosh edhe gjatë udhëtimit. Tabletët ofrojnë internet kudo që ndodhesh. Lundrimi në internet është shumë i thjeshtë, tabletat janë të rehatshme dhe të lehta në përdorim.

Tabletat ofrojnë shumë aplikacione në shërbim të përdoruesve. Tabletët mund të përdoren si pajisje navigacioni GPS. Ato janë shumë të përshtatshme për të marrë shënime, sigurojnë një regjistrim zëri shumë të pastër dhe shumë e shumë aplikacione të tjera.

Edhe në Shqipëri ka hyrë një numër i madh tabletash. Në Shqipëri mund t'i gjejmë tabletat nëpër dyqanet e kompanive celulare, dyqanet elektronike apo qendra tregtare. Gjithashtu, një pjesë e mirë e shqiptarëve i sigurojnë tabletat nga të afërmit e tyre që kanë jashtë

Grafiku i paraqet të dhënat në milion njësi.



vendit, nga ebay dhe faqe të tjera që ofrojnë shitje të ndryshme elektronike.

Avantazhet që ofrojnë tabletat kanë bërë që ato të përdoren në fusha të ndryshme të jetës. Duke filluar që nga punonjësit e zyrave, punonjësit në terren, janë shumë të përshtatshme për konferenca, nga drejtuesit e emisioneve televizive madje edhe nga fëmijë të moshave të ndryshme. Gjithashtu, tabletat kanë filluar të përdoren edhe në shkolla, si nga ana e mësuesve ashtu edhe nga ana e studentëve.

Duke parë shërbimet e tabletave do vëme re edhe disa disavantazhe të tyre. Madhësia e ekranit është shumë e vogël për të punuar me programe të komplikuar

inxhinierike. Ekranit është shumë i ndjeshëm dhe mund të dëmtohet më shpejt se i laptopave. Ne jemi mësuar dhe na duken më të rehatshme tastierat tradicionale. Tabletat nuk kanë shumë porta hyrëse dhe nuk kanë vend për CD apo DVD.

Për të parë se cilat janë tabletat më të mira është bërë një studim nga Jhon McCann për techradar.com. Ai i studion tabletat duke marrë parasysh mimin e tyre, sistemin e operimit, shpejtësinë, madhësinë e ekranit, cilësinë e retinës, aplikacionet që përdor secila dhe shumë ana të tjera. Ai ka nxjerr këtë përfundim.

1. Sony Xperia Tablet Z
2. iPad mini
3. Google Nexus 7
4. iPad 4
5. Google Nexus 10
6. Samsung Galaxy Note 8.0
7. Asus Transformer Pad Infinity
8. Microsoft Surface Pro
9. Samsung Galaxy Note 10.1
10. Apple iPad 2



The screenshot displays the homepage of the 'Objektiv' news website. At the top left is the 'Objektiv' logo. To its right is a circular emblem with the text 'Kujdesemi për ju, sipas do të donim të kujdeseshin për ne.' Below the logo are social media icons for Twitter (7), Facebook (15), and Google+ (3). A search bar with 'Redaksa' and 'Kontakt' labels is on the right. A navigation menu includes: Aktualitet, Politikë, Ekonomi, Panshqiptare, Bota, Sociale, Kulturë, Intervistë, and Reportazh.

The main content area features a large article with a photo of three people at a table. The headline reads: **Pezullohet përkohësisht zbatimi i marrëveshjes Kosovë-Serbi**. The sub-headline states: **Kosova dhe Serbia pezullojnë përkohësisht zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit. Për rrjedhojë, deri në shtator nuk do të ketë zhvillime në shpërbërjen e strukturave paralele të sigurisë dhe as kriminit**. Below the article are navigation arrows labeled 'Prev' and 'Next'.

Below the main article is a grid of smaller news items under the categories 'Aktualitet', 'Politikë', and 'Ekonomi':

- Aktualitet:** A photo of a blue car on fire with police officers. Headline: **Shkrumbohet një automjet para Kryeministritë**.
- Politikë:** A photo of a man speaking at a podium. Headline: **Berisha: Qeveria e re barrë e rëndë**.
- Ekonomi:** A photo of people at a counter. Headline: **Rritja e pensioneve, ISSH pu**.

On the right side of the page, there is a vertical sidebar with a 'Cilësia pastore' logo, social media icons, and a list of sports-related news items, including 'Juve "blindon"', 'Milani nuk heq Honda', and 'Bajern, 46 milion për David Luiz'.

Na ndiqni në Facebook, Twitter dhe Google+ :





KLINIKA DENTARE "VRIONI"

Cilësia, pasioni ynë.

IMPLANTOLOGJI IMEDIATE

Te gjithë ju qe keni mungese te nje-disa ose te gjithë dhembeve dhe nuk deshironi te qendroni pa dhembe apo te mbani protezate levizshme, mjafton nje vizite tek ne dhe brenda 24 oreve ju do te keni dhembe fiks (te pa levizshem) mbi implante.

ORTODONCI

(Drejtimi i dhembeve)
Trajtim me aparate te levizshem , dhe fikse metalike, fikse qeramike (estetike te padukshme), Invisalign, per drejtimin e dhembeve dhe korrigjimin e problemeve te kafshimit. Konsulta dhe studimi i rastit falas.

PER FEMIJET

Sherbim I specializuar, ne nje ambient te dizenuar enkas per femijet ku ata mjekohen, duke u relaksuar e argetuar.

SEDACIONI

Mjekimi nen efektin e Gazit Gazmor. Ne rastet e frikes nga punimet dentare tek te rriturit apo femijet, kryhen punimet nen efektin qetesues te protoksidit te azotit.

STOMATOLOGJI ESTETIKE


Nderthurje e materialeve te gjenerates se fundit (IPS Empress, IPS E Max) me nderhyrjet kirurgjikale per gingivat.

KIRURGJI ORALE

Ura Porcelani metal-porcelan, zirkonium, Alumina (ura krejt qeramike, pa metal)

SHERBIM KOMPLEKS

Staf mjekesh profesionist,te diplomuar e specializuar ne Turqi & Itali



Adresa:

Tek 21 Dhjetori, Rr. Frosina Plaku, ndermjet hotel "Mondial" dhe Fakultetit te Inxhinierise se Ndertimit, 50 m. nga "Unaza". tel: 04222 1637 cel: 0672005000, 0684079989, 0692306899
www.vrionidental.com